Objektiv

Viti I i botimit | Nr. 4 | Shkurt 2 014 | Çmimi 250 Lekë - 2 euro

Të jesh nëna e Arbit

Editorial
Vetëcensura në median shqiptare

Reportazh
Nga gjaku në gjak

Shëndetësi
Duhanpirja, a e parandalon rritja e taksave?

Objektiv

Kryeredaktor
Ramadan Çipuri

Redaksia
Alba Boriçi
Ana Koldashi
Emirjon Senja
Erlis Çela
Ilda Shytaj
Rudi Dunga
Romelda Qose

Grupi i këshilltarëve
Agron Hoxha
Agron Tufa
Alban Tartari
Briseida Mema
Gentiana Skura
Idaver Sherifi

Këshilli i etikës
Aleksandër Çipa
Bashkim Gjergji
Lutfi Dervishi
Mark Marku

Kontribuan në këtë numër
Altin Tufa
Elta Liksenaj
Jonida Halili
Najada Fosa
Marenglen Kume
Rabihana Halili
Romina Qama
Xhevahir Qardaku

Redaktor letrar
Rrahim Ombashi

Marketingu
Rudi Dunga
Erzen Carja

Dizajni
Ejup Lila

Fotografia
Irfan Karaabo
Fotoja e kopertinës: Soela Zani

Telefon
+355 42 419 222
+355 67 30 44 464
Adresa: Rr. Jordan Misja, Kompleksi Usluga,
Tiranë - Shqipëri

Editorial
Vetëcensurimi i çimentuar në redaksitë e medias shqiptare
- Nga Ramadan Çipuri

Intervistë
Të jesh nëna e Arbit - Nga Romelda Qose

Aktualitet
Një vit sa një dekadë - Nga Emirjon Senja

Opinion
Politika e “pikës zero” si armikja kryesore e zhvillimit të një vendi
- Nga Erlis Çela

PANSHQIPTARE
Mbledhja e Prizrenit-fillimi i një ere të re bashkëpunimi
Shqipëri-Kosovë - Nga Rudi Dunga

Sociale
A jemi ne skllevër të medias? - Nga Ana Koldashi

Bota
Bota në 2013 - Nga Rabihana Halili

Bota
Një vit i keq për njerëzit e medias - Nga Romina Qama

Shëndetësi
40 % e shqiptarëve pijnë duhan, a na shpëton taksimi i cigares?

Reportazh
Nga gjaku në gjak - Nga Xhevahir Qardaku

Reportazh
Për një jetë më të mirë - Nga Najada Fosa

Intervistë
Ata janë kampionë, shteti u bën “mat” - Nga Elta Liksenaj

Intervistë
Biznes-arti i rrugës - Nga Altin Tufa

Opinion
Maska virtuale, një realitet i kohës sonë - Nga Andi Pepa

Kulturë
Copëza nga jeta e goranëve të Kukësit - Nga Alba Boriçi

DOSSIER
Si u sekuestrua ari shqiptar nga regjimi komunist - Nga Hasan Bello

Shkencë
Kalimi i shpejtësisë së dritës…Të udhëtosh në fantazi - Nga Ejup Lila

Teknologji
Viti i “inteligjentëve” - Nga Marenglen Kume

Sport
Unë mund të luaj futboll. Po ti? - Nga Jonida Halili

EDITORIAL

Nga Ramadan Çipuri

Vetëcensurimi i çimentuar në redaksitë e medias shqiptare

Vetëcensurimi është një ndër sfidat më të mëdha, me të cilat media shqiptare ballafaqohet sot. Në këta 20 vite, ecuria e zhvillimit është shoqëruar me fenomene të ndryshme, nga të cilat më i dallueshmi e pa dyshim dhe me pasoja direkte ka qenë pronësia mediatike. Roli i gazetarëve ka pësuar ndryshime. Gazetaria nga vetë natyra e saj, sot përbën një lloj aktiviteti të mbushur me konflikte të shumta. "Qentë e cirkut kërcejnë, kur trajneri i tyre përplas kamxhikun"- shkruan George Orwell, "por një qen i mirëstërvitur kërcen vetë edhe kur nuk ka fare kamxhik". Kjo është një ndër ironitë më therrëse, por e vërtetë, që kam lexuar në lidhje me vetëcensurimin, i cili pushton gazetarët jo vetëm në Shqipëri, por pothuajse në mbarë botën. E njëjtë kudo që ekziston, vetëcensura përbën një ndër frenimet më të mëdha gazetareske për zhvillimin profesional të tyre. Në një artikull mbi këtë temë, Jeff Cohen dhe Norman Solomon e krahasojnë vetëcensurën me vesën e mëngjesit. Me keqardhje, Cohen dhe Solomon thonë se është e frikshme, veçanërisht në periudha të vështira ekonomike, të mendosh të kafshosh dorën e atij që të firmën për rrogën me të cilën paguhesh.

Në këtë udhëkryq të vlerave, gazetari shqiptar lidhet përherë e më shumë pas pronarit të mediumit ku punon, i cili në sytë e tij paraqet një shtyllë të qëndrueshme për karrierën e tij. Kushtet në të cilat gazetarët shqiptarë ushtrojnë profesionin e tyre duket se ndikohen si nga qëndrimet e pronarëve apo redaktorëve, po ashtu edhe prej politikave qeveritare. Ka një trend në rritje të përfitimit financiar dhe presionit të kësaj natyre. Në një vend ku mungojnë sindikatat, zbatimi i ligjit apo respektimi i statusit të gazetarit, ky profesion po humbet gjithnjë e më shumë vendin e merituar. Gazetarët, disa prej të cilëve punojnë pa kontrata, duhet t'iu përshtaten interesave dhe shijeve të pronarëve të tyre dhe të zbatojnë axhendat që iu serviren. Të keqpaguar, në gazeta me stafe të vogla dhe në më të shumtën me punonjës të pasiguruar, edhe ata që kanë nisur me entuziazëm punën e kanë lënë pas disa vitesh në këmbim të një pune që jep më shumë siguri dhe të ardhme. Shumë gazetarë shprehen se shkaqet e largimit nga gazetaria lidhen drejtpërdrejtë me statusin social të gazetarëve, pagesat e ulëta, vonesa e vazhdueshme e rrogave, trajtimi aspak profesional, puna në kushte jo të mira etj.

Raportet e institucioneve ndërkombëtare vazhdimisht vënë theksin mbi atë çka mund ta quajmë punë pa siguracione. Një numër i madh gazetarësh vazhdojnë ende të punojnë pa kontrata. Për më tej, ajo që të shqetëson më shumë është edhe se në Shqipëri akoma nuk ka një institucion rregullator për mediat dhe se unionet e gazetarëve vazhdojnë të kenë një ndikim të vogël.

Sot vihet re se në Shqipëri nuk ka konkurencë reale në treg, por konkurencë mes bizneseve për të mbajtur gjallë, për të financuar gazetat e tyre. Një pjesë e konsiderueshme e mediave kanë si pronarë njerëz që merren me biznese të tjera dhe që gazetën a televizionin e tyre e mbajnë thjesht për të mbrojtur a zhvilluar këto biznese. Në këtë kontekst, edhe raporti i pronarit të medias me gazetarin ndërtohet me vartësinë e efiçencës në realizimin e misionit të këtij pronari.

Problemi duket se qëndron që në momentin e çeljes së një organi mediatik. Skema mediatike e mbingarkuar dhe fragmentizuar në Shqipëri nuk shpjegohet dot nga pikëpamja e logjikës së tregut. "Shqipëria mban vendin e parë në Evropë për nga numri i gazetave të ndryshme për frymë, por renditet e fundit në Evropë kur bëhet fjalë për tirazhin e gazetave të përditshme për frymë, sepse në total, këto të përditshme prodhojnë më pak se 100.000 kopje" - thotë Remzi Lani, drejtor i Institutit të Medias.

Përtej gazetave, tani në Shqipëri është kthyer e modës që çdo kompani e madhe private të ketë një kanal televiziv apo një radio, një revistë apo buletin, duke mos harruar këtu mundësitë që Web 2.0 ju ofron. Pra, në një farë mënyre, këto kompani furnizojnë këto mjete informimi me fonde të ndryshme, jo në interes të informimit publik, por në interesat e tyre. Në kushte të tilla, për gazetarët është më se e vështirë të bëjnë gazetari. Të gjitha këto ndikojnë në një autoritet më imponues dhe më diktues të politikave redaksionale të bazuara në përfitime të caktuara të drejtuesve/pronarëve mediatik përkundrejt gazetarëve. Abdi Baleta drejtoi një pyetje në qershor të vitit 2003: "Kush do ta frenojë ofensivën, që po i zë frymën lirisë së shtypit?!" Fatkeqësisht kanë kaluar më shumë se plot dhjetë vjet, por edhe sot e kësaj dite, mbetet një pyetje pa një përgjigje. Sot është koha kur pikërisht sindikatat, unionet e gazetarëve, universitetet që ofrojnë programe gazetarie, apo vetë gazetarët të rrisin përpjekjet për të vënë në vend nderin e këtij profesioni fisnik.

Nga Romelda Qose

Të jesh nëna e Arbit

Ndryshe nga një pjesë e shoqërisë, të cilët kur mësojnë se fëmija i tyrë është me nevoja të veçanta (Sindroma Down) i zë paniku dhe mbyten në trishtim, Emanuela Zaimi ka zgjedhur një rrugë tjetër. Ajo është përpjekur që t'i vijë në ndihmë djalit të saj ,Arbit dhe të gjithë fëmijëve që kanë lindur dhe lindin të atillë.

Emanuela pas 2 vitesh angazhimi intensiv vullnetar dhe sensibilizues ka arritur të institucionalizojë përpjekjen e saj, duke themeluar fondacionin e parë për fëmijë që vuajnë nga kjo sindromë, "Down Syndrome Albania". Shoqëria e njeh si iniciatore e shumë aktiviteteve të ndryshme në shërbim të sensibilizimit dhe humanitetit ndaj personave me sindromën Down. Në tetor, muajin dedikuar "Ndërgjegjësimit për sindromën Down", Emanuela në bashkëpunim me tenorin shqiptar me famë boterore Sajmir Pirgun ka organizuar një koncert në TOB.



Emanuela me Arbin. Foto: Armand Habazaj

Në cilën orë bie alarmi i ziles në mëngjes për Emën?

Deri para pak ditësh që isha ende në punë dhe Arbi ende s'kishte nisur çerdhen zgjohesha në 8:00, për të qënë në 09:00 në punë. Tani që kam hyrë në lejen e paralindjes dhe Arbi shkon në çerdhe, zgjohemi rreth orës 07:30, por jo me alarm celulari apo ore, por nga zëri i Arbit që vjen nga dhoma e tij nëpërmjet autoparlantit të monitoruesit të fëmijëve. E këto ditë pasi Arbi dhe Kledi (bashkëshorti) lënë shtëpinë, unë shijoj edhe 2-3 orë të tjera gjumë, duke qënë se ky muaji i fundit i shtatzanisë më ka sjellë edhe ca probleme pagjumësie.

Cili është motivi me të cilin e nisni ditën tuaj?

Këto ditë motiv për mua janë dy gjëra: përgatitjet për ardhjen e motrës së Arbit dhe mbyllja e disa takimeve, punëve dhe çështjeve që kanë të bëjnë me fondacionin "Down Syndrome Albania". Pas një fushate dhe një sërë aktivitetesh të sukseshme në tetor, muajit të sensibilizimit për sindromën Down, po përgatitemi për hapjen e qendrës së shërbimeve, të cilën urojmë ta inaugurojmë me 21 mars, në ditën botërore për sindromën Down.

Ku e pini kafen e mëngjesit?

Kur jam në punë, kafenë e mëngjesit e pimë me kolegët në zyrë. Ndërsa këto ditë kafeja e mëngjesit është shumë e vonshme, rreth orës 12:00. Orë në të cilën gjendem rreth zonës së bllokut ose parkut "Rinia" për ta pirë me ndonjë mikeshë, mik apo ndonjë partner strategjik për DSA-në. Duke qenë se nuk e ngas dot makinën në këtë periudhë dhe jam rënduar për të ecur, i lë takimet për kafetë e mëngjesit sa më afër stacioneve të autobuzave . Periudha e lejes së paralindjes po më shijon shumë. Takoj miq që nuk kam pasur kohë t'i shoh për një kohë të gjatë, për shkak të rutinës së jetës së përditëshme. Pra, kam jo pak edhe kohë të lirë.

Si e organizon ditën një nënë si ju, që përtej angazhimeve në punë ka edhe detyrime specifike për Arbin?

Jashtë kësaj periudhe që ndodhem tani, dita është pak a shumë si e gjithë nënave që janë në marrëdhënie pune e ndoshta kanë fëmijë për të shoqëruar në kurse të ndryshme. Arbi për moshën dhe nevojën që ka, pas çerdhes, duhet të ndjekë disa terapi. Tre ditë në javë Arbi bën terapi të psikomotorrikës dhe të gjuhës (logopedi) me një terapist që fatmirësisht na vjen në shtëpi nga ora 18:30-19:30. Dy ditë të tjera Arbi

pas çerdhes (18:00-19:00) bën terapi fizike në një klinikë private fizioterapie. Atje e shoqërojmë dhe unë dhe Kledi (bashkëshorti). Ndërkohë që terapinë e zhvillimit Arbi e bën dy herë në javë në çerdhe. E kemi sistemuar në atë mënyrë që terapistja të shkojë në çerdhe, për të shfrytëzuar dhe paraditet. Mbrëmja mbetet për të sistemuar Arbin për të ngrënë, larë e fjetur. Jam me fat, sepse kam një bashkëshort që më ndihmon shumë, si me kujdesin ndaj Arbit, ashtu edhe në shtëpi, plus që kemi dhe dadon gjatë ditës. Pra, në një farë mënyre jam një mami me shumë ndihmë në shtëpi dhe pothuajse mund të konsiderohem si një mami aspak si nënat tipike shqiptare (si nënat tona p.sh.) që nuk ulen deri kur të gjithë kanë fjetur. Në mbrëmje vonë, pasi Arbi ka fjetur, unë gjendem përgjithësisht duke lexuar mbi sindromën ose duke punuar në kompjuter për DSA-në. Jam person që nuk fle para mesnate dhe në fakt kohët e fundit as nuk e kam luksin dhe po të dua ta bëj këtë.

A gjendet ndopak kohë e lirë në ditët tuaja?

Kur bëhesh prind, krijon familje dhe je edhe në marrëdhënie pune, s'para ke kohë të lirë. Por sigurisht që mundohemi të koordinohemi me Kledin

për të frekuentuar të paktën 2-3 herë në muaj miqtë tanë që ende s'kanë detyrime familjare. Kemi shumë afër dhe prindërit e Kledit dhe kështu kur kemi nevojë apo dëshirë për të dalë, Arbi rri me ta. Tani me pritjen e një fëmijë të dytë dhe me impenjimet e DSA-së, druaj se s'do këtë më shumë kohë të lirë, por gjithsesi nuk është se kam nevojë për të pas një kohë të lirë timen. Për mua, koha më e mirë është koha cilësore që shpenzoj me Arbin.

Çdo të thotë të jesh nënë e një fëmije me nevoja të veçanta, në rastin tënd me një fëmijë me sindromën Down?

Nuk mundem ende ta krahasoj veten me një nënë që ka një fëmijë pa nevoja të veçanta, por nëse duhen renditur gjërat ndryshe , ato do të ishin:

Preokupimi për të gjetur mundësitë në vendin ku jetojmë, në mënyrë që Arbi të marrë shërbimet e duhura (quhen ndryshe "terapitë e ndërhyrjes së hershme") për të arritur maksimumin e potencialit të tij në zhvillim.

Angazhimi kohor për t'i ndjekur dhe për të respektuar rutinën e këtyre shërbimeve (terapive).

Puna e vazhdueshme që duhet të bëjmë edhe ne si prind, sidomos në aspektin e komunikimit me Arbin. Nëse një prind tjetër flet me fëmijën e vet në formë shumë të çliruar, pasi e di që fëmija e tij herët a vonë do flasë, ne me Arbin komunikojmë për ta ndihmuar për të mësuar për të folur. Përsërisim shpesh fjalët, për t'i pasuruar fjalorin (pra, edhe pse ai nuk i flet, i mëson dhe i kupton këto fjalë). Mundohemi të artikulojmë shkurt dhe qartë. Mundohemi të flasim gjatë gjithë kohës në shtëpi. P.sh.: kur gatuajmë apo kur bëjmë ndonjë punë, ne e pershkruajmë veprimin.

Nga ana tjetër, duke qënë se tashmë me krijimin e DSA-së kemi marrë përsipër të bëjmë përpjekje maksimale për të ndryshuar dhe përmirësuar çdo aspekt të jetës për një person me sindromën Down dhe familjarëve të tyre në Shqipëri, më vë kryesisht mua përballë një sfidë tjetër, atë të ruajtjes së balancave mes punës, familjes e kësaj sipërmarrje. Që në tetor e këtej ajo që mendoj vazhdimisht është, sikur dita të ishte më e gjatë.

Përveç sa më sipër, çdo gjë tjetër besoj është si për çdo nënë tjetër. Marr dhe jap dashuri pa kufi. E në fakt kjo është më e vlefshmja mbi çdo gjë. Krijimi i një atmosfere sa më të dashur dhe jetese normale (pra, të paafektuar nga fakti që ke një fëmijë me nevoja të veçanta) në një familje ku ka një person me sindromën Down është më efektive se çdo terapi. Ne të dy si prindër kemi pasur fatin të pranojmë menjëherë Arbin. Të kuptojmë nevojat e tij. Ta shikojmë ashtu siç e ndjejmë atë (si gjënë më të shtrenjtë në botë, fëmijën) dhe kjo ka bërë që të ruhen balancat në familje. Çdo fëmijë mbi të gjitha ka nevojë për një ambient familjar të shëndetshëm.

Mendoni që Arbi ju ka bërë më të fortë?

Fëmija të bën më të fortë, më kërkues ndaj vetes, më të përgjegjshëm dhe sigurisht që edhe Arbi ka pasur këtë efekt. Të bëhesh nënë, për mua do të thotë të plotësohesh si femër. Arbi më ka bërë jo vetëm më të fortë, por dhe më të mirë. Më ka ndryshuar shumë aspekte në karakter, më e rëndësishme më ka mësuar të njoh durimin e të vlerësoj gjërat e vogla e të thjeshta në jetë, por edhe të jem më kërkuese ndaj vetes.

Prisni të sillni në jetë një vajzë, si po e përjeton Arbi ardhjen e një motre?

Arbi është 28 muajsh. Kemi dëgjuar nga prindër të tjerë, por edhe më të lexuar që fëmija i parë duhet përgatitur për ardhjen e motrës apo vëllait të tij dhe ne këtë kemi bërë gjatë kësaj periudhe. Vazhdimisht i tregojmë Arbit që te barku i mamit ka një motër. Ai i di emrin tashmë dhe më përkëdhel barkun sa herë i kërkojë që t'i bëjë motës "xhan xhan". Pra, Arbi e di që ekziston një Dea, e di krevatin e saj, m'i tregon rrobat e saj dhe ma do mendja kur ta sjellim në shtëpi dhe do e shoh fizikisht nuk do jetë surprizë shumë e madhe për të. Uroj që edhe pas këtij momenti ne si prindër të jemi në gjendje të menaxhojmë situatat e xhelozive që ndodhin te fëmijët e parë kur ka ardhur i dyti. Mendoj që pas disa muajsh sidomos kur Dea të jetë rritur për të lozur me Arbin, Arbi do ndihet

shumë mirë.

Sa mendoni se do të ndikojë kjo në jetën e Arbit?

Fëmijët me sindromën Down që kanë vëllezër dhe motra janë me fat, sepse kjo ndihmon shumë edhe në zhvillimin e tyre, sidomos nëse janë në mosha të afërta. Pra, jemi të bindur që kjo do ndikojë veç për mirë në këtë aspekt. Për të tjerat do ndikojë si në çdo familje kur vjen fëmija i dytë. Natyrshëm, vëmendja s'do të jetë vetëm tek Arbi, por te të dy me të njëjtën rëndësi.

Keni qenë iniciatore e shumë aktivitetetve për kauzën e sindromës Down. A mendoni se ka ndryshuar disi reagimi i shoqërisë shqiptare kundrejt fëmijëve dhe personave me këtë sindromë?

Padyshim që po. Kjo jo e thënë nga unë, po nga persona të tjerë. Shpërndarja e informacionit mbi çfarë është sindroma, cilat janë nevojat dhe cili është potenciali ka bërë që realiteti të shihet ndryshe nga kushdo, përfshirë edhe prindërit e këtyre personave. Ajo çfarë ne synojmë është që ky sensibilizim të vlejë më së shumti edhe për profesionistët, si: mjeke, edukatore, mësues, punonjës sociale etj. Nëse krijohet një ambient ku të gjithë informohen me informacion të saktë dhe jo bazuar mbi mite për sindromën dhe mbi të gjitha krijojmë një pritshmëri nga personat me sindromën Down, kjo do të thotë krijim i një mundësie për të pasur një jetë si gjithë të tjerët dhe për personat me sindromën Down në Shqipëri: të marrin shërbimet që kanë nevojë, të frekuentojnë çerdhe, kopshte e shkolla, të aftësohen për punësim e për një jetë të pavarur. Pra, të jenë plotësisht të integruar në shoqëri. Kjo në shumë vende të botës ka kohë që është realizuar!

A jeni ndjerë ndonjëherë e paragjykuar?

Unë vetë jo, por kam ndjerë të paragjykojnë Arbin. Për shembull sa herë që Arbi ka probleme me shëndetin dhe duhet ta çojmë te një mjek që se kemi çuar më parë, në vend që të fokusohen te problemi shëndetësor (viroza, temperatura, etj.), mjekët preferojnë të merrën me "sindromën". Si ndodhi, pse ndodhi e më ekstremja që të shprehen se "viroza është më i vogli problem që Arbi ka".

Jam e bindur e në fakt e dëgjoj edhe nga nënat me fëmijë në një moshë më të madhe se Arbi, që paragjykimi është prezent në shumë aspekte të jetës (shkollë p.sh). Mendoj që njeriu paragjykon për sa kohë është i panjohur dhe i painformuar për diçka, apo i keqinformuar. Prandaj edhe unë dhe DSA-ja i japim shumë rëndësi informimit të saktë mbi sindromën dhe çdo gjë rreth saj. Gjithsesi, në çdo shoqëri ka paragjykime e kjo e jona nuk mund të ishte ndryshe. Krahasimisht me vendet e tjera, mendoj që populli ynë më tepër se paragjykon, ka për zakon të ndjejë keqardhje dhe gjynah. Por, këto të dyja kanë një efekt njësoj si paragjykimi, pasi nuk shohin përtej, nuk besojnë dhe nuk kanë pritshmëri në potencialin që qëndron te diçka apo dikush "ndryshe". Duhet të krijojmë e të investojmë në një shoqëri që pranon dhe vlerëson diversifikimin. Kjo jo vetëm për sindromën, por edhe për shumë e shumë kauza e aspekte të tjera shoqërore.

Si ka qenë reagimi i familjeve të tjera që kanë fëmijë me sindromën Down pas aktiviteteve që keni organizuar?

Në fakt ajo çfarë më pëlqen më shumë është ndjenja e bashkësisë. Tashmë njihemi me shumë prindër (me një pjesë të konsiderueshme dhe virtualisht). Reagimi është shumë pozitiv, inkurajues, por edhe me pritshmëri të larta përkundrejt çështjeve edhe më të mëdha. Sfidë mbeten shërbimet e ndërhyrjes së hershme për fëmijët 0-3 vjeç, përgatitja e tyre për parashkollor dhe shkollë (arsimi gjithëpërfshirës), aftësimi i tyre për punë dhe jetë.

"Fëmijët me sindromën Down që kanë vëllezër dhe motra janë me fat, sepse kjo ndihmon shumë edhe në zhvillimin e tyre, sidomos nëse janë në mosha të afërta"

Nga Emirjon Senja

Një vit sa një dekadë

Shqiptarët e gjeten veten të përfshirë në një fushatë të ethshme të zgjedhjeve të përgjithshme që në javët e para të vitit 2013. Opozita e atëhershme kishte filluar takimet elektorale, ndërsa qeveria "hapi thesin" e shpenzimeve që në muajt e parë të vitit duke u bërë shkak ndoshta edhe për një rritje të lehtë të përgjithshme të çmimeve, fenomen i cili vijoi edhe gjatë muajve të verës. Është një fenomen fushatash ky, ku paraja gjendet në treg relativisht më shumë krahasuar me periudhat e tjera. Por, cilat ishin momentet më të rendësishme të vitit që sapo lamë pas?

Fitorja e purpurt

Me një imazh krejtësisht të ri, me premtime për lehtësimin fiskal të një pjesë të mirë të popullsisë, rritjen ekonomike, luftën ndaj korrupsionit si edhe vendosjen e rendit publik, koalicioni i majtë i udhëhequr nga Partia Socialiste do të vinte në pushtet me një numër prej 84 deputetësh pas tetë viteve ne opozitë. Zgjedhjet shqiptare u vlerësuan si demokratike dhe të rregullta edhe nga Brukseli duke i rritur shpresat vendit për marrjen në tentativën e radhës të statusit të vendit kandidat për në BE.

Largimi i një lideri

Një fryme të tillë pozitive i shërbeu edhe qasja e opozitës së re ndaj zgjedhjeve duke i pranuar ato pa kundërshtime si një "vendim të sovranit". Në këtë filozofi, por edhe duke marrë përsipër rezultatin negativ të shënuar në zgjedhje, erdhi edhe dorëheqja nga drejtimi i partisë e liderit të PD-së dhe kryeministrit përgjatë tetë viteve, Sali Berisha. Me një fjalim prekës dhe të transmetuar drejtpërdrejtë në media duke kapur rekordet e audiencës në

Shqipëri, Berisha ngarkoi mbi supet e tij fajin për humbjen e 23 qershorit duke i hapur rrugën zgjedhjes së një lideri të ri të PD-së, Lulzim Bashës. Duke parë sjelljen politike gjatë dy dekadave të Berishës, duhet theksuar se një tërheqje e tillë e tij do të surprizonte jo pak shqiptarë por edhe funksionarë të kancelarive evropiane.

Qeverisja e fytyrave të reja

Kabineti qeverisës, i prezantuar nga Rama në shtator, për të cilin u diskutua shumë gjatë muajve të nxehtë të korrikut dhe gushtit do të shquhej për moshën mesatare të re si edhe për shumë fytyra të tjera, të cilët nuk kishin frontin e parë gjatë opozitës së tetë viteve. Të tillë do të ishin edhe drejtuesit e institucioneve dhe drejtorive në varësi direkte nga qeveria. "Goditja" e parë e qeverisë Rama do të ishte shtyrja e hyrjes në fuqi e ligjit për nëpunësit civil, miratuar nga qeveria Berisha, gjë e cila u lexua nga të djathtët si tentativë për të lehtësuar pushimet masive nga puna në administratë.

Fitorja dhe humbja e parë

Rivendosja e rentit publik dhe marrja e statusit të vendit kandidat për në BE do të ishin "bastet" e para të qeverisë Rama vetëm pak muaj pas ardhjes në pushtet. Pas ndërrimit të të gjithë kupolës drejtuese të policisë si edhe të një numri të konsiderueshëm policës rendi dhe rrugor, në publik filloi të perceptohej se punët me rendin po shkonin mirë. Ndryshe ndodhi me marrjen e statusit ku vende si Britania e Madhe, Hollanda apo Gjermania do të vendosnin veton kundër duke shtyrë shpresat shqiptare për në muajin qershor të këtij viti. Ky në fakt do të ishte edhe dështimi i parë i kabinetit Rama.

Ekonomia

Përmirësimi i treguesve financiar edhe ekonomik të vendit ishin një ndër premtimet më të mëdha të të majtëve dhe si e tillë, aplikimi i reformave sigurisht që do të duhej të bëhej nëpërmjet ligjeve të reja në këtë drejtim. Në këtë frymë, maxhoranca e majtë ndryshoi pjesën dërrmuese të ligjeve që kanë të bëjnë me administrimin fiskal në vend duke ndërhyrë në ligjin për TVSH-në, akcizat, taksat kombëtare, etj., të cilët do të ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e shqiptarëve gjatë periudhave në vijim. Ndryshimet fiskale të qeverisë Rama, si një nevojë për një stimul të ri në ekonomi, ndodhën në një periudhë kur treguesit e konsumit ishin në minimumin vjetor duke e bërë 2014-ën një vit sfide për të majtët.

Humbja e një alternative

Pas dorëheqjes së Sali Berishës, Sokol Olldashi shihej si një alternativë serioze për drejtimin e të djathtëve krahas kryetarit të tyre aktual. Si një alternativë ndryshe, ai doli përballë Bashës në zgjedhjet për kryetar duke sugjeruar një qasje frytëdhënëse afatgjate për PD-në, e cila po bëhej gati për disa dimra me radhë në opozitë. Largimi nga jeta në fund të 2013-ës, zyrtarisht për shkak të një aksidenti me makinë e Sokol Olldashit ishte në fakt edhe humbja e një alternative tjetër për të djathtën shqiptare.

Viti i provës për qeverinë Rama

Pas ndryshimeve rrënjësore në paketën fiskale, administrimin e doganave dhe e tatimeve, me një mbështetje 84 votash, si edhe me zellin e fitimtarit, qeveria Rama e ka të lirë fushën për të filluar aplikimin e programit të saj ekonomik

Qeveria shfrytëzoi tre muajt e mbetur të 2013-ës për të bërë ndryshimet e planifikuara për programin e saj qeverisës, duke ndërhyrë në sistemin fiskal të vendit, në ligjin për administratën publike, në sistemin shëndetësor. Një reformë e tillë u shoqërua edhe me ndryshime rrënjësore të drejtuesve të drejtorive, apo njësive të tjera në varësinë direkte dhe indirekte të ekzekutivit. Në këtë mënyrë, qeveria e nisi vitin 2014 me ligjet dhe administratën e saj, gjë e cila i lejon të aplikojë pa asnjë pengesë programin e premtuar në elektorat gjatë zgjedhjeve, por edhe pritshmëritë e votuesve. Ka një mori sektorësh, në të cilët pritet ndërhyrja e ekzekutivit, por dy më kryesorët, të cilët ndikojnë thuajse jetën e të gjithë shqiptarëve janë ekonomia dhe rendi publik.

RENDI

Me gjithë ndryshimet rrënjësore në strukturën drejtuese të policisë së shtetit, shqiptarët e mbyllën vitin 2013 dhe filluan 2014-ën duke qenë dëshmitarë të disa grabitjeve spektakolare në qendra tregtare dhe sheshe qytetesh. Krahas kësaj, javët e fundit janë shënuar disa raste të hyrjes dhe grabititjes me dhunë në shtëpi, krime këto të cilat në një pjesë të mirë të tyre ende nuk janë zbardhur.

> ‘‘Qeveria e nisi vitin 2014 me ligjet dhe administratën e saj, gjë e cila i lejon të aplikojë pa asnjë pengesë programin e premtuar në elektorat’’

Gjobat

Megjithatë, vërehet një prani e shtuar në rrugë e forcave të policisë së rendit për kontrolle, si edhe një nxitje e policisë rrugore për të vendosur disi situatën nën kontroll pas disa aksidenteve tragjike përgjatë fundit të 2013-ës.

Ndërkohë, vetëm gjatë muajit dhjetor, mësohet se të paktën 6 për qind e të gjithë përdoruesve të makinave në Republikën e Shqipërisë kanë marrë të paktën një gjobë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Sipas Drejtorisë së përgjithshme të policisë, efektivët rrugorë vendosën rreth 21 mijë gjoba. Ndëshkimi i shkelësve duket se është rruga e zgjedhur nga organet e policisë për të vendosur rregullin në rrugët shqiptare.

Krimi

Nga ana tjetër, forcat e rendit kanë shënuar disa suksese për sa i përket sekuestrimit të lëndëve narkotike me qëllim trafikimin brenda dhe jashtë vendit, edhe pse deri më tani nuk është parë e arsyeshme të ndërhyhet me ndonjë aksion të gjerë në zona të caktuara të vendit për ndalimin e prodhimit. Kohët e fundit, Shqipëria është kthyer vitin e fundit në një vend kalimi tranzit të emigrantëve të paligjshëm nga vendet e Afrikës Veriore apo të Lindjes së Mesme. Thuajse çdo javë kapen grupe emigrantësh të futur ilegalisht në vend me qëllim kalimin për në Evropën Perëndimore.

EKONOMIA

Shqipëria e mbylli vitin 2013 me një sërë treguesish jo shumë shpresëdhënës në ekonomi, pavarësisht disa përmirësimeve në drejtimin e mbledhjes së të ardhurave në buxhet nga doganat, si pasojë e importeve të jashtëzakonshme të karburanteve dhe cigareve në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

Buxheti

Duke miratuar një buxhet të guximshëm me rritje të ndjeshme shpenzimesh, qeveria Rama synon t'i japë një shtysë të re ekonomisë, duke injektuar para nga investimet publike në të. Qeveria nuk parashikon të hap fronte të mëdha në investimet publike, duke u mjaftuar vetëm me përfundimin e veprave të nisura. Megjithatë, fondi i investimeve kapitale për 2014-ën parashikohet 65 miliardë lekë, rreth 8 miliardë lekë më pak se 2013. Totali i shpenzimeve të parashikuara është 455 miliardë lekë.

Po ku do të gjenden gjithë këto para shtesë, të cilat do të mundësojnë edhe shlyerjen e borxheve ndaj kompanive, të cilat kanë kryer punë publike gjatë viteve të shkuara? Përveç rritjes së borxhit në më shumë se 990 miliardë lekë, burimi kryesor i rritjes së të ardhurave të qeverisë pritet të jetë rritja e përgjithshme e taksave, me të cilat do të përballen qytetarët shqiptarë.

Paketa fiskale

Ndryshimet në ligjin për të ardhurat parashikohet të lehtësojë një pjesë të mirë të pagamarrësve dhe bizneseve. Ndërkohë, rritja e akcizës sidomos për karburantet, pritet të shtrenjtojë jetesën e qytetarëve, pavarësisht nëse janë apo jo pronarë të një automjeti. Kjo, për faktin se rritja e kostos së transportit për bizneset prodhuese pritet të pasqyrohet te çmimet e produkteve. Nga ana tjetër, shtrenjtimi i karburanteve u ka dhënë një tjetër justifikim kompanive të shërbimit urban dhe pronarëve të autobusave interurban për të kërkuar me ngulm rritjen e çmimit të biletës për udhëtarët.

Sfidat e 2014-ës

Referuar edhe shumë treguesve të trashëguar edhe nga vitet e kaluara, ky vit pritet të jetë guri i provës për aftësitë qeverisëse të kabinetit Rama. Por, cilët janë disa nga fushat, të cilat përbëjnë vërtetë një sfidë për ekzekutivin? Problemi më i rëndësishëm me të cilin qeveria do të përballet është rënia e ritmeve të rritjes ekonomike të vendit.

Rritja ekonomike

Ekzekutivi ka parashikuar një rritje reale prej 2 për qind të ekonomisë gjatë këtij viti, shifër kjo e certifikuar edhe nga Banka Botërore. Edhe pse vazhdon ritmin pozitiv, një rritje në këto shifra nuk i shërben shumë ekonomisë shqiptare, e cila është ende në zhvillim dhe ka nevojë për një hov më të madh se ky.

PunësimiNgadalësimi i ritmeve të rritjes ekonomike nuk është një fenomen i tanishëm, madje për muaj me radhë është reflektuar edhe te treguesit e punësimit në vend. INSTAT raporton me një rritje të vogël të nivelit të punësimit në sektorin privat gjatë tremujorit të tretë të vitit të shkuar (shifrat e tremujorit të katërt nuk janë dalë ende). Nga ana tjetër, punësimi në sektorin publik vijon të tkurret, e cila pritet të ndodhë edhe këtë vit me shkurtimin e 1 200 vendeve të tjera të punës. Pas një rënie të fortë gjatë vitit 2012, niveli i papunësisë në Shqipëri ka të paktën një vit që ka ndaluar në 12.8-12.85 për qind.

Konsumi

Stanjacioni njëvjeçar i rritjes së punësimit, rritja e përgjithshme e nivelit të taksave në vend, si edhe ngrirja e rritjes së pagave për sektorin publik pritet të japë ndikimin e parë në nivelin e konsumit në vend, tregues ky që nuk është se ka pasur ndonjë të shkuar të mira gjatë vitit të fundit. Të dhënat e Ministrisë së Financave tregojnë se pavarësisht shkurtimeve në buxhetin e vitit 2013, të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, tregues i cili lidhet drejtpërdrejtë me treguesit e konsumit, nuk janë realizuar sipas planit.

Kreditimi

Ajo që i duhet më shumë tani ekonomisë shqiptare, për një përmirësim të shpejtë të treguesve është kreditimi. Por, pavarësisht uljes së vazhdueshme të normave të interesit për lekun nga Banka e Shqipërisë, portofoli i kredisë së bankave tregtare vazhdon të mos zgjerohet, përkundrazi. Nga njëra anë, janë bizneset dhe individët që po kërkojnë më pak kredi, nga ana tjetër janë bankat, të cilat duket se po shtrëngojnë kushtet e kreditimit në një kohë, kur kredia e keqe po rritet. Qeveria raporton se deri në peridhën e fundit të vitit të shkuar, ka një tkurrje prej më shumë se 2 për qind të portofolit të kredisë së bankave dhe ndikuesi kryesor i kësaj gjendje duket të jetë ulja e kërkesës nga bizneset. Banka e Shqipërisë ka çuar në tre për qind normën bazë të interesit për lekun, me shpresën se kjo do të nxisë kreditimin.

Nga Erlis Çela



Politika e "pikës zero" si armikja kryesore e zhvillimit të një vendi

Në këto dy dekada e pak pluralizëm politik, Shqipëria ka realizuar shtatë herë zgjedhje parlamentare. Nëse në këtë llogaritje përfshijmë edhe zgjedhjet e vitit 1991, atëherë mund të themi se tetë herë me radhë u jemi drejtuar kutive të votimit në një ambient politik, ku alternativat e zgjedhjes kanë qenë më shumë se një. Ndonëse tashmë po mbërrijmë në gjysmën e dekadës e tretë të një sistemi demokratik, niveli i zhvillimit, progresi shoqëror dhe ekonomik, mirëqenia dhe prosperiteti i shqiptarëve është ende shumë larg pritshmërive dhe potencialit që ka ky vend.

Ndoshta secili prej nesh lexon çdo ditë shkrime, analiza dhe komente me karakter kritik, mbi arsyet e kësaj prapambetjeje, apo më mirë të themi të këtij zhvillimi të vonuar. Shumë gazetarë, analistë, brenda dhe jashtë vendit, madje edhe shumë prej të huajve, të cilët paguhen për të na ndihmuar për të përshpejtuar pikërisht ritmet e zhvillimit, na flasin çdo ditë për arsyet pse ne nuk kemi ecur më shpejt drejt Europës së zhvilluar.

Siç ndodh rëndom në këto raste, faji ngelet gjithmonë jetim për të gjetur përgjegjësin, një herë ia hedhim fajin vetes, një herë komunizmit që na la kaq vite të izoluar. Më pas shkojmë larg në histori dhe ia hedhim fajin pushtimit otoman. Ndonjëherë e kanë fajin dhe fqinjët që na e kanë gjithmonë me hile e kështu me radhë. Megjithatë, e vërteta e një tranzicioni të stërzgjatur qëndron e padiskutueshme dhe na mbetet të shohim se kur do të vijë ajo ditë që të mos e dëgjojmë më frazën " shoqëri në tranzicion". Pa dashur t'i hyj një analize historike sesi kanë arritur vendet e tjera në rajon dhe më gjerë, që të kapërcejnë periudha të ngjashme në historinë e tyre, më duket e arsyeshme të qëndroj në një pikë, të cilën do ta konsideroja thelbësore për të pasur një shtet dhe një ekonomi me zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm.

Në të gjitha ndryshimet e pushteteve në këto 20 e kusur vite, ne kemi zgjedhur ta nisim gjithmonë nga pika zero. Fakti që nuk kemi funksionuar sipas shembullit

të një ekipi atletike në garën katër herë katër, ku atleti që vjen i dyti e vazhdon garën nga pika që e ka lënë i pari dhe kështu me radhë, i fundit, kur prek finishin, e ka të qartë se nuk ka vrapuar i vetëm në ato 400 metra dhe se suksesi nuk është personal, por i të gjithë ekipit.

Ne jemi dëshmitarë sesi pas çdo palë zgjedhjesh, pala që vjen në pushtet, në rastin më të mirë mohon çdo arritje të paraardhësve dhe në rastin më të keq shkatërron çdo gjë që është arritur. Revanshi dhe politika e hakmarrjes ndaj kundërshtarëve që kanë humbur pushtetin, zbresin deri në nivelet më të ulëta të qeverisjes, duke u kthyer në një uragan që zhbën çdo gjë që ka arritur kundërshtari, me arsyetimin e vetëm se nuk i atribuohet pikërisht triumfatorit të ri. Pas çdo zgjedhje dhe pas çdo ndryshimi pushtetesh, administrata qendrore, ribëhet nga e para, policia dhe forcat e rendit ristrukturohen nga e para, duke ndryshuar dhe policin më të thjeshtë që është rojë objekti, administrata doganore po ashtu, tatimet sigurisht që janë të parat që preken.

Gjithë kjo lëvizje, përveç se është një kohë dhe energji e shkuar kot dhe që i sjell kosto qytetarit shqiptar, është gjithashtu arsyeja kryesore pse vazhdojmë ta kemi ende këtë situatë tranzicioni të pafund. Rendi publik vihet në rrezik për shkak të lëvizjeve dhe ndryshimeve të mëdha në polici. Të rinjve u duhet kohë të kuptojnë sesi funksionon struktura e policisë. U duhet kohë të rivëjnë në funksion lidhjet me terrenin për të mbledhur informacion dhe për ta parandaluar krimin, që gëlon në rrugë. Situata e këtyre ditëve, ku dëgjojmë të paktën 2 shpërthime me tritol në ditë dhe vrasjet që ndodhin në mes të ditës, duke krijuar një klimë pasigurie, e ilustron më së miri këtë sjellje me strukturat e rendit në këtë vend.

Po kështu, edhe përsa i përket funksionimit të tregut, administrata e re tatimore dhe doganore, puna e parë që bën është rinovimi i listës së bizneseve që janë "miq" të kundërshtarëve politikë dhe bizneset "mike" të partisë që ka ardhur në pushtet. Trajtimi klientelist, në kundërshtim me ligjin, ka bërë që biznesi shqiptar të paguajë një haraç të rëndë, që se ka lënë të ngrejë kokën për të konkurruar me tregjet e rajonit dhe më gjerë. Debati thuajse i zakonshëm pas çdo ndërrimi pushteti, për spastrimin e administratës nga "specialistët" dhe mbushjen e saj me " militantë", në fakt tregon pikërisht këtë realitet të hidhur, që mbetet ende pengesa më e madhe për këtë vend drejt konsolidimit të demokracisë.

Ky debat mbetet vetëm në rrafshin politik duke e parë si betejën e radhës mes pozitës dhe opozitës, por askush nuk llogarit koston që i sjell ekonomisë e gjithë kjo rokadë dhe sa shumë na stopon në kohë logjika e të rifilluarit gjithmonë nga "pika zero". Zgjidhja për këtë problem, e cila është mëma e të gjithë këtij ngërçi, do të vijë vetëm në atë moment kur njerëzit në këtë vend nuk do ta shohin shtetin si punëdhënësin e vetëm dhe si shpresën për t'u pasuruar me shpejtësi.

Nëse krahas kuadrit ligjor, që me thënë të drejtën s'na ka munguar asnjëherë, do të vendosni dhe me vullnetin për të respektuar dhe për të mbështetur specialistët e vërtetë të administratës, do të zhduknim imazhin se në shtet fitohet para, duke bërë korrupsion. Nga ana tjetër, do t'i krijonim frymëmarrje sektorit privat, në mënyrë që të rritej dhe të krijonte vende të reja pune, atëherë do të kemi vërtet një "pikë zero", nga ku do të fillojë zhvillimi i këtij vendi.

Nga Rudi Dunga

Mbledhja e Prizrenit-fillimi i një ere të re bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë

Qyteti historik i Prizrenit priti për herë të parë në një mbledhje të përbashkët qeverinë e Shqipërisë dhe qeverinë e Kosovës. Takimi i zhvilluar më 11 janar 2014 është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për simbolikën e vet që mbart, por edhe për vendimet e marra. U desh të kalonin disa vite që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, që qeveritë e dy vendeve të gjenin vullnetin dhe të diskutonin për mundësitë e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.

Në një marrëveshje pesëfaqëshe të nënshkruar nga kryeministrat Edi Rama dhe Hashim Thaçi, Shqipëria dhe Kosova angazhohen të bashkëpunojnë ngushtësisht, ku prioritet i vihet proceseve të integrimit rajonal dhe euroatlantik. "Qëllimi i këtij takimi ka qenë zbatimi i marrëveshjeve të mëparshme dhe forcimi i marrëdhënieve tona"- u shpreh në çelje të takimit kryeministri kosovar Hashim Thaçi, duke shtuar se në Prishtinë dhe në Tiranë ka një vullnet politik, ku marrëdhëniet mes dy shteteve të jenë një shembull i mirë për të gjithë rajonin.

Në anën tjetër, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e vuri theksin te ruajtja e kufijve aktualë, duke pasur si synim të vetëm të të dyja vendeve integrimin sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian. "Të gjithë duhet ta dinë, se ne e dimë fort mirë se liria, demokracia dhe dinjiteti i një kombi nuk kanë të bëjnë me kufijtë shtetërorë, por me qeverisjen dhe aspiratat e saj për shtetin dhe vlerat e patjetërsueshme të respektit, qoftë për detyrimet ndaj familjes së shteteve ku duam të integrohemi plotësisht si anëtarë të denjë, qoftë për detyrimet ndaj çdo anëtari të familjeve të dy shteteve tona, që nuk i përket kombësisë sonë"- tha z. Rama.

Pse Prizreni?

Prizreni mbart një simbolikë të veçantë për kombin shqiptar. Në qytetin jug-perëndimor të Kosovës më 10 qershor 1878 u mbajt kuvendi mbarëkombëtar, në të cilin u tubuan më shumë se 300 përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare, përfshirë edhe shqiptarët nga Bosnja dhe Sanxhaku. Lidhja e Prizrenit kishte si qëllim formimin e një shteti autonom shqiptar që do të përfshinte të gjitha vilajetet osmane që banoheshin nga shqiptarët. Kjo ishte lidhja e parë e madhe e organizuar politikisht, administrativisht dhe ushtarakisht për të krijuar një shtet të bashkuar shqiptar. Për këtë arsye, Prizreni në mënyrë figurative paraqitet edhe si kryeqyteti i gjithë shqiptarëve. Këtu nuk la pa e përmendur në fillim të takimit edhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi: "Sot jemi këtu në qytetin e bukur, në qytetin e krenarisë sonë kombëtare, në qytetin e historisë, në qytetin e së ardhmes, në qytetin e Prizrenit".

Vendimet e marra në mbledhjen e përbashkët

Shqipëria dhe Kosova më 11 janar 2014 nënshkruan një sërë marrëveshjesh, ku mbi të gjitha vlerësohen proceset integruese, me qëllim për t'u bërë pjesë e një historie të re dhe perspektivës së pakthyeshme të integrimit evropian dhe sigurimit të paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit. Qeveritë e dy vendeve akorduan një fond simbolik për rikonstruksionin tërësor të maternitetit të Preshevës në Serbi, i cili nuk funksionon prej dekadash. 100 mijë euro që do të akordohen për këtë qëllim janë fondi i parë që qeveritë tona japin për rajonin shqiptar të mbetur nën kufijtë shtetërorë të Serbisë.

Në deklaratën e përbashkët Shqipëria dhe Kosova zotohen për thellimin e bashkëpunimit në politikën e jashtme, duke theksuar mbështetjen e dialogut të nisur me Serbinë. Në marrëveshje nuk u la pa përfshirë angazhimi për shtimin e njohjeve të mëtejshme të Kosovës, angazhimit të saj në organizatat ndërkombëtare, me qëllim final anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Konkretizimi i angazhimeve në fushën e kulturës, arsimit dhe të shkencës do të bëhet në mbledhjet e ardhshme të përbashkëta që do të mbahen mbi bazën e një kalendari të rregullt, ku përgjegjës për përgatitjen e tyre do të jenë dy ministrat e jashtëm të qeverive respektive.

Thellimi i bashkëpunimit midis institucioneve në zbatim të ligjit është një tjetër pikë e rëndësishme e marrëveshjes. Gjithashtu, të dyja shtetet angazhohen për ndihmë reciproke në rast të emergjencave civile, si edhe masave për sigurinë rrugore. Fusha e ekonomisë zë pjesën më të rëndësishme në deklaratën pesëfaqëshe të bashkëpunimit, duke nisur nga heqja e pengesave për shkëmbimet tregtare. Prej kohësh ishte përfolur për përfshirjen e Kosovës në projektin e TAP, ndërkohë që me nënshkrimin e marrëveshjes së re do të shihet mundësia e krijimit të një degëzimi edhe për këtë vend. Qeveritë zotohen për nxitjen e krijimit të një klime të favorshme biznesi, si edhe ndërtimin e një strategjie të përbashkët për turizmin.

Reagimi i faktorit politik shqiptar në Maqedoni

Kreu i partisë më të madhe opozitare shqiptare në Maqedoni, Menduh Thaçi, nuk e priti edhe aq mirë takimin e zhvilluar në Prizren mes dy qeverive. Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare mendon se në atë mbledhje duhet të ishte përfshirë edhe faktori politik shqiptar në Maqedoni. Për më tepër, sipas z. Thaçi, vëmendje iu kushtua vetëm shqiptarëve në Luginën e Preshevës, pa u përmendur fare popullata shqiptare në Maqedoni.

Në anën tjetër, kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, e përshëndeti takimin e Prizrenit, duke e quajtur si një akt të rëndësishëm historik që do të ndikojë në lehtësimin e unifikimit të faktorit shqiptar në rajon. Edhe zëvendëskryeministri Talat Xhaferri, i cili vjen nga radhët e BDI-së, u shpreh se edhe qeveria maqedonase është e gatshme të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me qeveritë e vendeve fqinje.

Autobusi me gjoba të papaguara

I gjithë kabineti qeveritar zgjodhi që drejt Prizrenit të udhëtojë me autobus. Fillimisht ky veprim tërhoqi vëmendjen e opinionit, jo se është ndonjë praktikë e panjohur në vendet e zhvilluara, por se në Shqipëri është përdorur vetëm në raste fushatash elektorale, madje me sukses edhe nga vetë kryeministri Rama përpara zgjedhjeve të fundit parlamentare.

Megjithëse me qëllimin për të krijuar një imazh ndryshe për qeverinë, kalimi i kufirit nga autobusi me gjoba të papaguara tregon qartë se në Shqipëri jo të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Mjeti me targë TR 42 65 T rezulton në regjistrin elektronik të policisë së qarkullimit rrugor me gjobë të papaguar dhe kjo nuk kaloi pa komente në media. Ky autobus i gjobitur për tejkalim shpejtësie thyen rregullin e vendosur nga vetë ministri Saimir Tahiri, duke treguar edhe "fytyrën pa grim" të qeverisë.

Kush mungoi në foton e përbashkët?

Pas nënshkrimit të marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Kosovës, të gjitha ministrat e dy qeverive u kujdesën të bëjnë edhe një fotografi të përbashkët para kompleksit të Lidhjes së Prizrenit. Kryeministrat Edi Rama dhe Hashim Thaçi u pozicionuan në qendër të fotografisë. Në foto mungoi zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, si dhe ministrja e Integrimit Evropian, Vlora Çitaku, të cilat gjendeshin në Bruksel për të diskutuar me përfaqësuesit e BE-së lidhur me komunat në veri të vendit. Veç tyre, në sy bie mungesa e ministrave serb në qeverinë e Kosovës. Aty mungon zëvendëskryeministri, njëkohësisht ministër i administrimit të pushtetit lokal, Slobodan Petroviç, si dhe ministrat Nenad Rashiç dhe Dalibor Jevtiç, pavarësisht se patën marrë pjesë në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive.

Nga Ana Koldashi

A jemi ne skllevër të medias?

Mund të thuhet pa frikë, se pushteti që zotëron media në ditët e sotme mbi mënyrën e konceptimit, përceptimit dhe interpretimit të ngjarjeve të profileve të ndryshme nga shoqëria është i pakrahasueshëm me ndonjë pushtet tjetër. Çdo gjë që ndodh sot është nën shënjestrën e mediave, të cilat mjaftohen me faktin që diçka ndodh, dhe ato janë në gjendje ta skalisin në atë formë që të quhet "lajm", për ta transmetuar atë tek audienca së cilës tashmë nuk i jepet më ajo rëndësi që i jepej dikur. Në treg po përjetohet një bum informacioni i cili serviret herë i filtruar dhe me shije të hollë dhe herë i stërmbushur dhe i ekzagjëruar.

Më shumë sesa informuese, media sot është kthyer në një fabrikë, e cila prodhon dhe ofron në mënyrë të pakontrolluar atë që ajo ka dëshirë të prodhojë, pa patur parasysh nevojat dhe kërkesat e konsumatorit. Pavarsisht këtij fenomeni, audienca nuk duket se është aq e shqetësuar për atë që po ndodh rreth saj, pasi fatkeqësisht ajo pranon çdo gjë që i ofrohet pa pasur një busull, e cila mund ta orientoi. Ndoshta sot shoqëria nuk është e vetëdijshme sa duhet për faktin se ne kemi ngelur në një udhëkryq të tillë, për arsye se informacionet që ne marrim nga media vizive dhe e shkruar janë pothujse të njëjtat, por në versione të ndryshme.

Ne po jetojmë në një periudhë nënshtrimi dhe skllavërimi ndaj medias. Televizioni dhe sidomos mediat online janë sot në krye të kësaj hiearkie, ku çdo fenomen rrotullohet rreth boshtit të tyre. Orët e pakontrolluara që kalojnë fëmijët dhe të rriturit para televizionit, si edhe pjesëtarët e tjerë të shoqërisë përpara Facebook-ut janë shenjat e para që tregojnë se nuk jemi ne ata që i kontrollojmë mediat, por është media ajo që na ka gllabëruar nën kthetrat e saj. Nga një studim i kryer dy vitet e fundit, statistikat tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë kalojnë mesatarisht pesë orë në ditë para televizionit dhe të rinjtë më shumë se tridhjetë e gjashtë orë në javë para kompjuterit. Të rinjtë 80% të kësaj kohe e kalojnë duke lundruar në Facebook, Tëitter apo Youtube. Sot të rinjtë nuk lexojnë, ata thjeshtë shfletojnë dhe klikojnë. Psiokologjia e fëmijës tejmbushet



me panorama dhe pamje, të cilat kjo moshë nuk arrin t'i përceptojë në mënyrë llogjike, por është e prirur t'i marrë dhe t'i imitojë në formë të pandryshuar në jetën reale. Ndërsa përsa i përket grupmoshave të tjera, ato thjeshtë janë gati të marrin atë që iu del përpara, pa u shqetësuar për zgjedhjen. Madje lidhja e tyre me median bëhet aq e fortë sa kjo besnikëri e tyre bëhet jo vetëm e vazhdueshme, por edhe tenton të rritet nga dita në ditë aq sa bëhet e pakontrollueshme.

Sipas studimeve të disa psikologëve thuhet që mediat ndikojnë ekstremisht në psikologjinë e ndjekësve të tyre, të cilët kanë tendencën të mbyllen në botën që iu "imponon" media, duke u shkëputur nga rrjedha reale e ngjarjeve. Media dhe kryesisht televizioni shkakton ftohjen e marrëdhënieve në familje, sidomos të fëmijëve ndaj prindërve. Ndërsa Facebook-u sot konsiderohet ndër faktorët bazë që ndikon në rritjen e gradës së pesimizmit te grupmosha të ndryshme, të cilët shumicën e rasteve tentojnë të kryejnë vetëvrasje në pamundësi të jetesës perfekte që reklamohet në profilet e ndryshme. Kjo jetë e që në pamje të parë duket sikur është perfekte, është në fakt thjeshtë një skenar i përgatitur për t'iu demonstruar të tjerëve, (të cilët vazhdimisht ose mundohen të imitojnë ose zhyten në pesimizëm për arsye se nuk zotërojnë një bukuri të tillë) një jetesë të tillë apo një popullaritet të tillë. Gjithashtu ky rrjet social është përgjegjës për rritjen e numrit të divorceve, fenomen i cili është gjithmonë e në rritje kudo nëpër botë.

Bota është kthyer në një sferë të vogël falë mediave, ku duket sikur çdo gjë është e hapur, tranparente dhe lehtësisht e identifikueshme, por në fakt çdo gjë që shikohet është "dukje" dhe jo "esencë". Kjo dukuri vjen si pasojë e ndryshimit drastik mes "qenies" dhe "shfaqjes", barrierë kryesore e ndarjes të së cilave është media. Bëhet fjalë për një shkallë shumë të lartë të prirjes për të imituar çdo gjë që shikohet dhe që është tërheqëse. Kjo mund të jetë prirje për të imituar një individ, një mënyrë jetese, një stil veshjeje etj. Sot media ushtron një ndikim të tillë tek audienca, saqë njerëzit kanë filluar të sillen si mediat e tyre. Në pamje të parë, ne jemi në gjendje të përzgjedhim një media të caktuar që i pergjigjet më shumë interesave tona, por përsëri e kemi të vështirë të bëjmë një ndarje përsa i përket vërtetësisë së ngjarjeve që pasqyrohen në rrjete të ndryshme.

Në ditët e sotme, media është kthyer në një pushtetare të fuqishme, i cili ka nën varësinë e tij përqindjen më të madhe të popullsisë. Është mjaft e lehtë për t'u kuptuar që ne në fakt jemi skllevër të medias, pasi ne veprojmë në baze të risive që sjell ajo, jetojmë në bazë të shembujve që parashtron dhe gradualisht çdo gjë e përcjellë për te ne shndërrohet në një mënyre jetese duke filluar që nga moshat më të vogla dhe deri te më të moshuarit. Kjo tendencë synon të shkëputet nga organizimi tradicional i një jetese të caktuar duke pasur ambicien që të lidhet me risitë që ndonjëherë nuk premtojnë vetëm progres, por edhe rrezikshmëri të lartë. Mënyra e vetme për të fituar liri nga vorbulla e medias është ndërgjegjesimi i vetes dhe shoqërisë për të vënë disa kufij disiplinues rreth mënyrës së organizimit të bashkëjetesës në familje dhe shoqëri.

Nga Rabihana Halili

Bota në 2013

Është e pamundur që në 365 ditët e vitit kalendarik, bota të mos jetë tronditur nga ngjarje të caktuara. Të tilla ngjarje me rëndësi dhe ndikuese për botën ka pasur edhe në 2013-ën. Ja disa ngjarje të cilësuara si më të rëndësishmet e 2013-ës.

Lufta në Siri

Lufta në Siri është cilësuar si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të 2013-ës. Luftë për të cilën folën mbarë mediat botërore. Lufta civile siriane solli vdekjen e 100 mijë njerëzve dhe nxiti krizën refugjate më të madhe në historinë botërore. Arma që zgjodhi këtë herë çnjerëzimi për të marrë jetën e mijëra njerëzve ishte gazi sarinë. Ky gaz shkaktoi vdekje nga më të pamëshirshme ndër luftra. Lufta mori përmasa të mëdha nga konfliktet midis rebelëve dhe rivalëve islamik, duke u përhapur kështu në të gjitha qytetet e Sirisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin të parat kundërshtuese të këtij krimi shfarosës. Presidenti Barack Obama i kërkoi Kongresit autorizim për sulm ndaj armëve kimike siriane. Bisedimet për paqe do të vazhdojnë edhe gjatë 2014-ës, gjatë të cilit pritet të arrihet një marrëveshje midis palëve.

Konfliktet egjiptiane, për ku po shkojnë?

Bota e sheh me keqardhje gjakderdhjen e pafund në Egjipt. Që prej 3 korrikut, vendi i është kthyer përsëri terrorit të 2011-ës në rrëzimin e Mubarakut. Protestat nisën pasi Presidenti i parë i zgjedhur në mënyrë demokratike Mohamed Morsi filloi të bëj ndryshime në Kushtetutën Egjiptiane, duke i shtuar kompetenca vetes. Kulmi i protestave arriti në 14 gusht. Qindra njerëz ngelën të vdekur. Shumë thonë se revolucionit egjiptian i erdhi fundi, por çështjet duken akoma kritike për ndonjë përgjakje tjetër.

Irani i ri

Irani thyen tabunë prej tre dekadash ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. President i ri Hassan Rouhani (i zgjedhur në qershor) bëri hapin e parë për një Iran më të hapur drejt bashkëpunimit dhe marrëveshjeve miqësore. Në nëntor, Irani tentoi një marrëveshje me Shtetet e Bashkuara për zvogëlimin e programit nuklear, përkundrejtë bilionë dollarëve.

Përgjimet Snowden

Informuesi i Agjencisë së Sigurimeve Kombëtare (NSA) Edward Snowden tronditi mbarë botën me zbulimin e dokumenteve të fshehura, të cilat faktojnë operacione të fshehta hetimore të SHBA-së kundrejt vendeve të tjera. Kancelarja gjermane Angela Merkel, e indinjuar mbi përgjimin e telefonit të saj, shprehu kritikat dhe mërzitjen ndaj SHBA-së. Këto përgjime shkaktuan humbjen e miliona dollarëve dhe mbi të gjitha ndikuan edhe në marrëdhëniet mes Uashingtonit dhe Moskës, të cilat mund të ishin tensionuar edhe më tepër.

Një papë ndryshe në Vatikan

Papa Benedikti i 16-të dha dorëheqjen për shkak të moshës madhore. Ai u zëvendësua nga kleriku argjentinas Jorge Bergoglio, i vetëquajturi Françesku i parë. Që në fillim u dallua për reformat e tij në Kishë, si edhe avokati i të varfërve. Françesku i parë sfidoi këndvështrimin tradicional të Kishës, si edhe kritikoi natyrën "kurnace" të kapitalizmit perëndimor.

Nga Romina Qama

Një vit i keq për njerëzit e medias

2013-ta është një vit me bilanc jo shumë pozitiv për botën e medias. Fjala dhe raportimi i lirë vijojnë të jenë të kërcënuara, pasi dhjetëra gazetarë u vranë për shkak të detyrës dhe qindra të tjerë përfunduan në burgje. Vëzhgimet dhe statistikat tregojnë shtetet problematike që kufizojnë lirinë e medias.

Numri i gazetarëve të burgosur në fillim të muajit dhjetor 2013 është 211, shifër kjo që tregon totalin e dytë më të lartë në 13 vitet e fundit, që kur "Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve" (CJP) nisi të publikojë një statistikë të tillë të përvitshme"- citon prestigjozja britanike "The Guardian".

Sipas një raporti të detajuar nga Elana Beiser, kryeredaktore e CPJ, Turqia kryeson për të dytin vit rradhazi listën e vendeve më me shumë gazetarë të burgosur, e pasuar nga Irani dhe Kina. Në fakt, këto tre shtete numërojnë më shumë se gjysmën e të burgosurve në total. Beiser shkruan se "Qeveritë jotolerante të Ankarasë, Teheranit dhe Pekinit përdorën akuzat antishtetërore për të mbyllur gojën e 107 gazetarëve, reporterëve e editorëve kritikë."

Turqia ka përmirësime, por sërish me 40 gazetarë të burgosur.

Numri i gazetarëve të burgosur në Turqi është ulur në 40 nga 49 që ishin një vit më parë, pasi disa prej tyre po ndiqeshin në gjendje të lirë. Të tjerë kanë përfituar nga legjislacioni i ri që lejoi të pandehurit në paraburgime të gjata që të dalin për arsye të kalimit të afateve kohore.

Gazetarë të tjerë u liruan pasi CPJ kishte përfunduar regjistrimin e saj. Megjithatë, autoritetet po mbajnë dhjetëra gazetarë kurdë të akuzuar për lidhje me ngjarje terroriste dhe organizime antiqeveritare. Sipas CPJ, kodi penal turk dhe formulimet e shumta në lidhje me antiterrorin lejojnë autoritetet turke të ndërhyjnë dhe shkrijnë organizime dhe grupime me anëtarësim.

Edhe Irani me përmirësime, aktualisht 35 gazetarë të burgosur.

Në Iran, numri i gazetarëve të burgosur është ulur në 35 nga 45 të një viti më parë. Kjo pasi disa çështje u zgjidhën për arsye të tejkalimit të afateve kohore, si edhe disa politikave qeveritare për të liruar disa të burgosur. Por, ata akoma nuk e kanë të sigurt nëse do të rikthehen sërish në qeli për të vazhduar dënimet e tyre.

Autoritetet e Teheranit po ashtu kanë vazhduar me arrestime të reja për të dënuar gazetarë reformistë, pavarësisht zgjedhjes në qershor të presidentit të ri, Hasan Rouhani.

Kina asnjë ndryshim, 32 të burgosur.

Me 32 blogues, reporterë dhe editorë të burgosur, Kina nuk ka asnjë ndryshim që nga viti 2012. Megjithëse disa gazetarë, përfshirë këtu edhe fituesin e CPJ për 2005-ën për lirinë e shtypit Shi Tao, u

liruan nga gushti i këtij viti...kanë nisur arrestime të reja.

Shtatë vende të tjera burgosëse të gazetarëve

Top lista e dhjetë vendeve me më shumë gazetarë të burgosur vijon me Eritrean, Sirinë, Azerbajxhanin, Vietnami, Etiopinë, Egjiptin dhe Uzbekistanin.

Egjipti shënon pesë gazetarë në qeli përkundrejt asnjë të burgosuri në vitin 2012. Në Siri, qeveria e Bashar Al Assadit mban në burg 12 gazetarë nga 15 që kishte një vit më parë. Por, në këtë shifër nuk përfshihen shumë reporterë të mbajtur nga forcat kundërshtare të qeverisë. Pothuajse 30 gazetarë rezultojnë të humbur në Siri.

Vietnami ka të burgosur 18 gazetarë, katër më shumë se një vit më parë, pasojë kjo e një ndërmarrjeje arrestimesh nga ana e qeverisë ndaj bloguesve, të cilët mendohen të jenë të vetmit përfaqësues të shtypit të lirë në vend.

Me 106 gazetarë pas hekurave, ata përbëjnë gjysmën e totalit. 79 prej tyre punonin në shtypin e shkruar. Rreth një e treta e tyre janë gazetarë të lirë.

Në të gjithë botën, 124 gazetarë janë burgosur nën akuzat antishtetërore si nxitje për përmbysje apo terrorizëm. Këta janë edhe akuzat më shumë të përdorura në këto arrestime.

CPJ, me qendër në Nju Jork, mbikqyrëse e lirisë së shtypit, e quan regjistrimin e saj mbi gazetarët e burgosur si "një shkrepje prej fotografi" në mesnatën e 1 dhjetorit 2013. Kjo nuk përfshin shumë gazetarë të burgosur dhe të liruar në të gjithë vitin. Në raport nuk përfshihen as gazetarët që janë zhdukur ose rrëmbyer.

Të paktën 70 gazetarë të vrarë në botën e 2013-ës

Sipas të përditshmes prestigjioze britanike "The Guardian" rezulton që gjatë vitit 2013 të ketë 70 gazetarë të vrarë, përfshirë këtu 29 reporterë që humbën jetën në luftën civile të Sirisë dhe 10 të tillë në Irak.

Sipas raportit të publikuar nga "Komiteti për mbrojtjen e gazetarëve" (CPJ), viktimat në Siri ishin kryesisht gazetarë të lirë, të cilët raportonin nga banesat e tyre , transmetues të cilët punonin me media pro dhe kundër qeveritare, një pjesë e vogël korrespondentësh të mediave të huaja, përfshirë këtu edhe gazetarin e Al-Jazëra, Mohamed al-Mesalma, i cili u qëllua nga një snajper.

Gjashtë është numri i gazetarëve të vrarë në Egjipt. Gjysma e tyre u vranë më 14 gusht nga sulmet e forcave të sigurisë egjiptiane kundër demonstruesve që kërkonin largimin e presidentit Mohamed Morsi.

"Lindja e mesme është bërë një arenë vrasjesh për gazetarët. Ndërsa në disa vende ka rënë numri i gazetarëve të vrarë për punën e tyre, lufta civile në Siri është një rifillim i sulmeve sektare. Në Irak kanë arritur në një numër dëshpërues"- tha në një deklaratë zëvendësdrejtori i komitetit, Robert Mahoney.

"Komuniteti ndërkombëtar duhet të mbizotërojë në të gjitha qeveritë dhe grupet e armatosura për të respektuar statusin civil të reporterëve dhe për të ndjekur penalisht vrasësit e gazetarëve."

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, me bazë në Nju Jork, ka ndjekur vdekjet mes reporterëve dhe transmetuesve televizivë që nga 1992.

Shumë prej vrasjeve që ai ka dokumentuar ndër vite përfshijnë njerëz që mbulojnë lajmet në vendet ku ata jetojnë. Kështu ndodhi edhe në rastin e 2013-tës.

Shumë prej vdekjeve ndodhën gjatë luftimeve, ose mes reporterëve që mbulojnë zonat e konfliktit, por gazetarë në disa shtete u vranë gjithashtu pas raportimit të çështjeve të ndjeshme.

Reporterët dhe komentatorët që mbuluan ngjarjet me sjellje të pahijshme të policisë (korrupsionin politik ose trafikun e drogës dhe çështje të tjera të ndjeshme) u ekzekutuan në "incidente" të veçuara në Brazil, Kolumbi, Filipine, Indi, Bangladesh, Pakistan dhe Rusi.

Një çift gazetarësh të Radios Ndërkombëtare të Francës u rrëmbyen dhe u vranë pas takimit me një lidër të grupit etnik separatist Tuareg në Kidal, në Mali. Militantët në Irak vranë pesë anëtarë të stafit të lajmeve të TV Salaheddin në një sulm vrasës këtë muaj në zyrat e kanalit televiziv në Tikrit, në Irak.

Për herë të parë në një dekadë, nuk bëhet e ditur të jenë vrarë gazetarë për punën e tyre në Meksiko.

CPJ po studion ende vdekjet e një shtese prej 25 gazetarësh gjatë 2013, të papërfshira në grupin e 70-ës, për të përcaktuar nëse vdekjet e tyre kishin të bënin ndopak me punën e tyre.

Deri më sot, të paktën 63 gazetarë janë vrarë në konfliktin në Siri, thotë raporti i CPJ-së, dhe ky numër mund ta nënvlerësoje problemin. Gjashtëdhjetë gazetarë u vranë në siri vetëm këtë vit. Ndërsa tridhjetë janë ende të humbur.

Nga Emirjon Senja

40 % e shqiptarëve pijnë duhan, a na shpëton taksimi i cigares?

Shqipëria renditet në listën e vendeve, ku numri i duhanpirësve ka njohur rritje në raport me popullsinë. Të dhënat tregojnë se vitet e fundit ka një rritje të ndjeshme të numrit të duhanpirësve femra. Studimet e Institutit të Shëndetit Publike gjatë viteve të fundit tregojnë se 40 për qind e popullsisë shqiptare është konsumatore e rregullt e duhanit, ndërsa vërehet një tendencë në rritje e femrave duhanpirëse. Referuar Studimit Demografik Shëndetësor, duhanpirja për gratë është e përqendruar kryesisht në zonat urbane, si Tirana, Durrësi, ku numri më i madh i duhanpirësve është midis moshës 20 deri 24 vjeç.

Gjithashtu ISHP thekson se në vendin tonë, 18 për qind e sëmundjeve që shkaktohen nga duhanpirja dhe pasojnë më pas me humbje të jetës prekin grupmoshat nga 30 deri në 59 vjeç. Sëmundjet më të përhapura janë ato kancerogjene dhe kardiovaskulare, duke shkaktuar sipas ISHP-së rreth 3 000 vdekje në vit vetëm nga pirja e duhanit.

Çmimi

Në kuadër të politikave të reja fiskale, qeveria ka vendosur të rrisë ndjeshëm taksat për cigaret, të paktën gjatë katër viteve në vijim. Me ndryshimet në ligjet fiskale një muaj më parë, qeveria vendosi të rrisë me 20 lekë akcizën për cigare, duke e çuar atë nga mesatarisht 70 lekë për paketë në mesatarisht 90 lekë për paketë, me një tendencë rritje deri në rreth 120 lekë për paketë deri në fund të vitit 2017. Rritja e akciës u pasqyrua menjëherë me rritje të çmimit të paketave, ku tregtarët u nxituan të "fusin në fuqi" taksat e reja, duke shtrenjtuar cigaret pa filluar të zbatohej ende regjimi i taksave të reja, me të paktën 20 lekë/paketë.

Akciza

Efekti i parë dhe afatshkurtër i rritjes së akcizës për cigaret është ai i rritjes së të ardhurave në arkën e shtetit. Pritet që vetëm gjatë këtij viti, buxheti të përfitojë plot 3.3 milardë lekë shtesë vetëm nga rritja e akcizës së cigareve plus 1 miliardë lekë nga rritja që do të aplikohet deri në vitin 2017.

Efekti afatgjatë ndërkohë pritet të jetë ulja e numrit të duhanpirësve në raport me popullsinë. Studimet e ndryshme tregojnë se një rritje me 10 për qind e çmimit të cigareve sjell ulje nga 3 deri në 5 për qind të duhanpirjes. Kjo shifër rritet edhe më tej kur bëhet fjalë për duhanpirjen te të rinjtë, ku shifra në fjalë mund të arrijë deri në 8-9 për qind. Çdo rritje taksash tek ata përkthehet menjëherë në ulje të duhanpirjes, për shkak të pamundësisë për të blerë cigare nisur edhe nga kushtet financiare. Një pjesë e mirë e të rinjve nuk janë ende në punë dhe të ardhurat kryesore i kanë nga familjet.

Të dhëna statistikore:

- 3 në 10 meshkuj konsumojnë duhan sot në gjithë botën
- 1 në 20 femra është duhanpirëse në rang botëror
- 6 miliardë e 250 milionë cigare u konsumuan gjatë 2012-ës në të gjithë botën

Rritet ushtria e duhanpirësve, pihen më shumë se 6 mld cigare në vit

Edhe pse numri i duhanpirësve po shënon ulje në shtete të caktuara, konsumi i duhanit dhe duhanpirësit po rriten ndjeshëm në raport global. BBC bën me dije se gjatë vitit 2012 numri i duhanpirësve arriti në 967 milionë persona krahasuar me 720 milionë që ishte në vitin 1980. Gjithashtu, mësohet se gjatë vitit 2012, në të gjithë botën u konsumuan plot 6 miliardë e 250 milionë cigare krahasuar me 4 miliardë e 960 milionë cigare të pira gjatë vitit 1980.

Të dhënat janë marrë nga 187 vende të botës. JAMA, gazeta e Shoqatës së Mjekëve të SHBA-s thekson se kjo rritje e numrit të duhanpirësve vjen edhe për shkak të rritjes së popullsisë në rang botëror. "Me dyfishimin e numrit të popullsisë gjatë gjashtë dekadave të fundit që nga viti 1950, sigurisht që është rritur edhe numri i personave që kanë këtë sjellje (duhanpirës)" - thekson JAMA.

Sipas kësaj të fundit, të dhënat tregojnë se janë kryesisht vendet në zhvillim ato që kanë rritjen më të madhe të numrit të duhanpirësve. Gjatë dekadave të fundit është vërejtur një rritje e numrit të popullsisë në disa vende të mëdha, si Rusia, Kina apo Bangladeshi, gjë e cila ka rritur edhe numrin e duhanpirësve në to. "Pavarësisht rritjes së madhe të numrit të duhanpirësve në disa shtete, shtrirja e duhanpirjes në rang botëror gjatë viteve të fundit po shënon ulje në raport me numrin e popullsisë"- raporton BBC. Referuar këtyre të dhënave, JAMA raporton se në ditët e sotme konsumojnë duhan afërisht 3 ndër 10 meshkuj dhe 1 në 20 femra në raport me 4 në 10 meshkuj dhe 1 në 10 femra që konsumonin në vitin 1980.

Por si është duhanpirja në vende të ndryshme të botës dhe në Shqipëri? Ku pihet më shumë dhe ku pihet më pak? BBC raporton se vendi me numrin më të madh të duhanpirësve është Timori Lindor. Mësohet se 61 për qind e popullsisë së këtij vendi konsumojnë cigare çdo ditë. Ndërkohë, për shkak edhe të kulturës së të jetuarit, vendi me numrin më të vogël të duhanpirësve mësohet të jenë Antigua dhe Barbuda, me vetëm 5 për qind të popullsisë duhanpirëse. Gjithashtu, BBC raporton se me gjithë rritjen e numrit të duhanpirësve në të gjithë botën, disa vende, si Kanadaja, Meksika, Islanda apo Norvegjia kanë shënuar përparime të rëndësishme për sa i përket parandalimit të pirjes së duhanit nga popullsia e tyre. Ndërkohë, vende, si Kina, Greqia, Rusia, Zvicra, Kuvajti, Filipinet etj. janë duke u përballuar me probleme serioze me rritjen e numrit të duhanpirësve, si edhe të sëmundshmërisë nga ky fenomen.

BBC citon Organizatën Botërore të Shëndetësisë teksa thekson se aplikimi i politikave antiduhan, si ndalimi i pirjes në vende publike apo rritja e taksave do të bëhej shkak për shpëtimin e jetës së miliona personave që vdesin nga duhanpirja. Amanda Sandford nga "Lëvizja mbi Duhanin dhe Shëndetin" thekson se "edhe pse numri i duhanpirësve në botë po rritet, studimi i JAMA-s tregon se është shumë e rëndësishme për vendet që të ndërmarrin politika parandaluese për duhanpirjen me qëllim uljen e sëmundshmërisë apo vdekjeve me shkaktar duhanin." "Vendet e varfra apo ato në zhvillim përballen në fakt me më shumë sfida për përballimin e industrisë së duhanit dhe uljen e numrit të duhanpirësve" -vijon ajo. Në fakt, një ndër masat e para që po marrin këto vende, krahas sensibilizimit është rritja e taksave për cigaret.

> "Studimet e ndryshme tregojnë se një rritje me 10 për qind e çmimit të cigareve sjell ulje nga 3 deri në 5 për qind të duhanpirjes"

10 ushqyesit më të mirë për një lëkurë të shëndetshme

Gjatë verës, lëkura e fytyrës ka nevojë për lagështirë të vazhdueshme, ndërkohë që gjatë pranverës nevojitet një terapi e veçantë vitaminash.

Lëkura duke qenë se është e ekspozuar ndaj elementëve të jashtëm, ajo duhet mbrojtur si në epidermë, ashtu edhe në hipodermë. Ndaj në dietën tuaj (e vlefshme edhe për meshkujt) duhet të përfshihen patjeter këto 10 ushqyes.

Lukopene

Lukopene është një antioxidant (antioksidanti është një emër përmbledhës për elementet që janë të afta të luftojnë radikalet e lira. Radikalet e lira vetë përfaqësojnë molekula speciale të afta për të shkatërruar molekulat e tjera si madje dhe qelizat e trupit. Ato normalisht supozohen se luftojnë viruset dhe bakteret duke marrë pjesë në prodhimin e hormoneve dhe proceseve të tjera jetësore) i fuqishme që ka rreze UltraViolet natyrore për mbrojtjen e lëkurës. Një dietë e pasur me lycopene i jep lëkurës suaj një mbrojtje ndaj rrezeve të dëmshme të diellit. Lukopenet mund të gjenden në shalqi, domate, portokall të kuq dhe papaja.

Astaxanthin

Astaxanthin është përbërës ngjyrë rozë që gjendet në ushqime të tilla, si në karkaleca ,salmon,karavidhe dhe në një gjallesë tjetër ujore të quajtur krill. Përdorimi në kohë të gjatë i saj ndikon dukshëm në shkëlqimin e lëkurës, duke reduktuar lëkurën e thatë, rrudhat dhe pikat e moshës.

Vitamina C

Vitamina C është e shkëlqyer për lëkurën si brenda saj, ashtu edhe në sipërfaqe. Ajo përmban antioxidant për të mbrojtur lëkurën tuaj nga radikalet e lira, duke inkurajuar prodhimin e kolagjenit. Ajo gjendet në fruta agrume, si lakra e Brukselit, speci i kuq, boronica, manaferra, kivi, portokalli, limoni, patate dhe brokoli

Vitamina A

A keni një fytyrë të thatë? Vitamina A ndihmon në mirëmbajtjen e pamjes së mire të lëkurës dhe largon helmet e dëmshme që përmban lëkura. Ajo mund të gjendet në karrota, spinaq, kajsi, lakër, shparag, qepë, bizele, kungull, kumbulla dhe në pataten e ëmbël.. Nëse ju keni mungesë të vitaminës A duhet të merreni konsulencën e një dermatologu, pasi nuk rekomandohet për të gjithë.

Omega 3 (acide të ngopura)

Omega 3 janë të lidhura me inflamacion të reduktuar dhe janë të njohura për të rritjen e shkëlqimit të çehres suaj . Omega 3 gjendet në ushqime si: peshku yndyror (të tilla si salmon), arrat dhe fara liri, bajame, lajthi etj.

Vitamina E

Vitamina E është e njohur për të luftuar efektet e dëmshme të ekspozimit UV dhe të sigurojë mbrojtje superiore antioxidante. Ekspertët tregojnë se përdorimi i vitaminës E natyrore 400 mg në ditë sjell përmirësim në fytyrat e dëmtuara dhe në fytyrat me rrudha. Ushqimet ne te cilat mund te gjeni me shumice vitamine E jane pothuajse te gjitha frutat dhe perimet.

Biotin

Biotin është një vitaminë B, e cila ndihmon në rrezatimin e fytyrës dhe të flokëve. Ekspertët rekomandojnë nga 1,000-5,000 mcg në ditë, e cila zakonisht kërkon një shtesë. Biotina mund të gjendet produktet e qumeshtit, vezet, peshk dhe mish i kuq.

Vitamina K

Vitamina K është cilësuar si një përbërës, i cili ndihmon efektivisht eleminimin e rrathëve të syrit. Ushqimet e pasuruara me Vitamin K janë: qepët e njoma, brokoli, lakra, kastraveci, kumbulla të thata, shparagu, piperi i kuq etj.

Acidi Hyaluronik

Acidi Hyaluronik ka aftësi të shquara për hidratimin e lëkurës suaj. Ai vepron në mënyrë efektive, duke i mbajtur qelizat e ndara. Acidin Hyaluronik e përmbajnë ushqime si peshku, veza, qumështi, kosi dhe fasulja.

Acidi Alpha Lipoik

Është një antioksidant i fuqishëm, një nga vetëm dy ushqyesit e tretshëm në ujë dhe yndyrë. Ky acid mbron lëkurën tuaj në brëndësi dhe sipërfaqe nga dëmtimi i radikaleve të lira. Acidi Lipoik gjendet nw ushqimw si brokoli, mëlçia, patatja, spinaqi etj

Nga Xhevahir Qardaku

Nga gjaku në gjak

Historia 20-vjeçare e një familjeje shkodrane, e cila i ruhet dy hasmërive. Një adoleshencë e lënë përgjysmë për të çuar në vend amanetin e gjyshit

Simon Vuka dhe vëllezërit Gjergj dhe Kolë Gjonlulaj ishin duke festuar së bashku Vitin e Ri 1994 në shtëpinë e këtyre të fundit. Pas të ngrënit dhe konsumit të alkoolit, këta të fundit u nisën të shoqëronin për në shtëpi mikun e tyre. Gjërat duket se shkuan keq midis miqve të vjetër dhe gjonlulajt qëlluan mbi Simon Vukën, duke hapur një histori 18-vjeçare gjakmarrjeje midis dy familjeve, të cilët më parë kishin qenë miq dhe që tani do të ishin hasëm (armiq).

Ngjarja që bëri shumë bujë asokohe, bëri që familja Vuka të largohej nga fshati duke u ngujuar në Bardhaj të Shkodrës. Ky fshat është shumë i njohur në Shkodër, pasi forca e Kanunit të Lekë Dukagjinit aty është trashëguar brez pas brezi, dhe si rrjedhojë kanë ndodhur shumë histori gjakmarrjeje.

***

Ndodhemi në qendër të fshatit bashkë me shoqëruesin tonë Ritvan Hyseni, banor i Bardhajt, i cili do të na drejtojë për te shtëpia e Tonin Vukës, vëllait të Simonit. Takohemi me Ritvanin në lokalin e fshatit. Hyrja jonë tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve për shkak se ne ishim të huaj në atë zonë. Lokali është i vogël dhe vetëm burrat mund të konsumojnë pije aty, me atë çka mund të dëgjojmë dhe të shikojmë ne është se ky është pak a shumë si një bujtinë e kohëve moderne, ku njerëzit ulen me miqtë apo me njerëzit e tyre dhe diskutojnë hallet e përditshme.

Shoqëruesi flet në telefon me Tonin Vukën dhe marrim konfirmimin e familjes Vuka për të na pranuar në shtëpi. Çohemi dhe bëhemi gati ta paguajmë kafen, por shoqëruesi ynë na thotë se neve nuk na lejohet të paguajmë, sepse ne jemi mysafirët e tij. Dalim nga lokali, ku tashmë të gjithë na përshëndesin, pasi me siguri kanë marrë vesh se kush jemi ne dhe çfarë qëllimi kemi.

Në rrugën plot gurë të vegjël të bie në sy zbrazëtia e saj dhe qielli i lyer me ngjyrën gri, të cilët shfaqin dhimbjen e madhe të këtij vendi. Rruga është shumë e qetë. E vetmja gjë që bën zhurmë është melodia e përroit që kalon anash rrugës. Shtëpitë nuk janë ato kullat e vjetra me gurë, por janë ndërtime të kohës, përveç disa shtëpive që janë të prekura nga gjakmarrja. Këto shtëpi janë të veçanta, sepse janë në majat më të larta të fshatit dhe janë prej guri. I gjithë fshati duket i zbrazur, vetëm gjëja e gjallë shëtit nëpër kullota.

Është ditë e acartë nëntori, bora ka zbardhur majat e maleve dhe ne na duhet pak kohë për të arritur deri te shtëpia e Toninit, sepse ajo ndodhet në një kodër dhe është më lart se shtëpitë e tjera. Shoqëruesi ynë thotë se ai e ka blerë me qëllim atë tokë dhe e ka ndërtuar shtëpinë aty vetëm për arsye vetëmbrojtjeje.

Në shtëpinë e Tonin Vukës. Fotot: Xhevahir Qardaku

Ne vazhdojmë të ngjitemi në terrenin e thyer të kodrës ku ndodhet shtëpia e Toninit, dalëngadalë ne ndodhemi tek oborri i shtëpisë, ku menjëherë dëgjojmë të lehurën e një qeni, i cili është sinjal lajmërues për të zotin e shtëpisë. Shtëpia është e pasovatuar mirë përjashta, nuk ka asnjë lule në oborr, çdo gjë duket e thatë dhe e heshtur, asnjë njeri nuk ndodhet në oborr. Ndërkohë, siç e do zakoni, ne thërrasim nga dera e oborrit "o i zoti i shtëpisë, a pranoni miq", menjëherë hapet dera dhe dëgjojmë një zë që na përgjigjet: "shpija e Zotit dhe e njirit asht gjithmon e hapun për miq". Afrohemi, ndërsa Tonini na thotë: "mirë se erdhët o njerëz të Zotit", shoqëruesi ynë përgjigjet: "mirë se ju gjetëm o shtëpi e Zotit" dhe futemi brenda në shtëpi. Aty gjejmë Toninin, gruan e tij dhe vajzën me mbesë. Shtëpia është e ndërtuar e re, por mesa duket gjakmarrja e ka transformuar në kasolle. Ata e kanë rregulluar siç kanë mundur shtëpinë, me orendi modeste. Muret nuk kanë suva të mirë brenda dhe e gjithë shtëpia nuk është e lyer me bojë. Rehatohemi. Na shërbehet kafeja.

Në foto: Alfred Vuka

Tonini është një burrë i gjatë me kapele në kokë, rreth të 50-ve, i vrarë nga hallet që ka kaluar dhe që po kalon dhe e vetmja gjë që mund të shfryjë ai pa ndonjë dëm është cigarja, të cilën nuk e heq nga goja. Ai tregon se familja e tij ka plot 19 vite që vuan gjakmarrjen, e cila dhe i detyroi që të shpërngulen nga rehatia e shtëpisë së tyrë në një kasolle vetëm për të gjetur sigurinë e frymës së tyre. Familja Vuka fillimisht ka banuar në fshatin Drisht, i cili ndodhet më në veri të qytetit, rreth 20 kilometra larg, por pasi ata ranë në gjak u shpërngulën në fshatin Bardhaj. "Banorët e këtij fshati i ofronin siguri"- (thonjzat do t'i vendosni nëse është e marr si citim nga personi në fjalë.) thekson Tonini. Tonin Vuka është në gjak me Mark Gjon Lulaj, që prej vitit 1994.

E gjithë historia fillon në vitin 1994. Gjergj dhe Kolë Gjonlulaj kanë vrarë me armë zjarri vëllain e Tonin Vukës, Simon Vukën, pas një debati të çastit. Pastaj ngjarjet morën rrjedhën dhe deri më tani janë bërë gjashtë vrasje. Në 1998 u vra Tom Marku në fshatin Mazrrek, vëllai i të plagosurit të atentatit të fundit , Lekë Marku, nip i autorëve të vrasjes së vitit 1994, të cilët ndodheshin në burg. Vrasja e këtij duket se

''Në rrugën plot gurë të vegjël të bie në sy zbrazëtia e saj dhe qielli i lyer me ngjyrën gri, të cilët shfaqin dhimbjen e madhe të këtij vendi''

Banesa e Tonin Vukës

i është ngarkuar familjes Vuka, edhe pse për të nuk ka asnjë të dënuar. Pas një viti është vrarë nusja e vëllait të Toninit në fshatin Shllak, nga një atentat ndaj Sandër Vukës. Në vitin 1999 vritet djali i xhaxhait në Shkodër, dhe në vitin 2000 vritet Pjetër Vuka në fshatin Mes. Gjakmarrja ka përfshirë në të edhe një minoren, Alfred Vukën, djalin e Simonit.

"Hera e fundit që asht ba vrasje për kyt ngujim ka ken vetëgjyqësia e Alfred Vukës, në datën 20 nëntor të 2012, nga mosfunksionimi i shtetit ligjor dhe keqkuptimi i Kanunit." Pas kësaj vrasje, gjendja ka filluar të qetësohet pak.

Gjaku i dytë

Alfred Vuka ishte vetëm 16 vjeç kur mori armën dhe bëri vetëgjyqësi ndaj një personi të quajtur Lekë Marku, "i cili ngjante vetëm nga mbiemri dhe që ndoshta nuk ishte autor i asnjë vrasje" ,- thotë Tonini. Alfredi, në fillimet e adoleshencës e ndërmori këtë veprim pasi ia kishte lënë amanet gjyshi i tij, Kin Mark Vuka, i cili kishte ndërruar jetë rreth një vit para se Alfredi të merrte gjak. Por, plani nuk shkoi ashtu siç e kishte bërë Alfredi. Objektivi i tij, Lekë Marku mbeti i plagosur, ndërsa plumbat vranë gabimisht një kalimtar, Aleksandër Qarrin. Plumba, të cilët futën për herë të dytë në gjak familjen Vuka. Tashmë ishin bërë më dy hasmëri.

"Alfredi kishte pasion muzikën folklorike dhe ishte shumë i talentuar. Ai pati marrë pjesë në shumë festivale të këngës folklorike dhe gjithashtu vazhdonte liceun arstistik "Prenkë Jakova" në qytetin e Shkodrës" - shpjegon i ati. "I kam ble lahutën 100 mijë lekë, pasi ai e donte shumë muzikën, por tani lahuta rrin e varun n'mur bashk me fotografinë e Alfredit" - vijon ai plot trishtim.

Alfredi nuk kishte lindur kur ka ndodhur vrasja e parë. Ai lindi në vitin 1996 dhe si për ironi të fatit ai u lind për të vrarë, u lind "për të vendosur nderin e familjes në vend". Tonini na tregon një foto të djalit të tij ku kishte kryer një rit fetar katolik, i cili quhej 'krezmim' dhe na thotë: "20 ditë pas krezmimit, ai bahet kriminel dhe kryen vrasjen, ku dhe hedh poshtë të gjitha ritet fetare."

Alfred Vuka tani ndodhet në burg ku po vuan dënimin për krimin e shkaktuar prej tij (për vrasje). Ai është në qeli, ku edhe do të shuhet pasioni i tij për muzikën, pasi nuk do të ketë më mundësinë ta ushtrojë atë dëshirë aq të zjarrtë të rinisë së tij. I vetmi tingull që ai do të dëgjojë është tingulli që lëshon hekuri i qelisë ku ai vuan dënimin. Gjaku që kishte shkaktuar gjithë ato vrasje tashmë ka marrë fund, pasi me ndihmën e kishës së fshatit "Guri Zi", dy familjet ishin pajtuar dhe gjaku ishte falur. Ata përsëri janë bërë miq. Ndërsa një gjakmarrje u shua, një tjetër mori jetë, ajo me familjen Qarri.

''Alfredi nuk kishte lindur kur ka ndodhur vrasja e parë. Ai lindi në vitin 1996 dhe si për ironi të fatit ai u lind për të vrarë, u lind për të vendosur nderin e familjes në vend''

Nga Najada Fosa

Për një jetë më të mirë..

Termi "për një jetë më të mirë" tashmë është bërë motoja e shumë shqiptarëve që transferohen drejt kryeqytetit të Tiranës. Një term i cili përfshin një gamë të gjërë faktorësh që i detyron shqipëtarët të largohen nga vendlindja e tyre.

Migrimi ndodh kur në vendin e lindjes këto individë nuk gjejnë mundësitë dhe burimet bazë për të ndërtuar ose vazhduar jetën e tyre në vazhdim. Shkaqet dhe arsyet e largimit janë të shumta, por destinacioni më i preferuar ngelet veç një: Tirana!

Por nuk mund t'i lëmë pa përmendur këto shkaqe dhe arsye, të cilat çojnë drejt këtij vendimi të rëndësishëm jetësor. Individë me statuse nga më të ndryshmet, si: familje, çifte të sapo martuar, të rinj, studentë të sapo diplomuar etj.

Papunësia është një ndër arsyet kryesore. Shumica e të rinjve edhe pse kanë mbaruar shkollat e tyre dhe kanë një përgatitje adekuate, përsëri mbesin të papunë kur kthehen në qytetin/ fshatin e tyre. Kjo gjendje i detyron të braktisin vendin e lindjes duke iu rikthyer kryeqytetit për një mundësi punësimi…

Kushte jo të mira të jetesës, gjendje e dobët ekonomike. Një pjesë e shqipëtarëve nuk janë të kënaqur me kushtet e jetesës në vendin e tyre. Disa familje nuk arrijnë që të mbulojnë shpenzimet bazike të jetesës dhe për një të ardhme më të mirë vendosin t'i largohen vendlindjes..

Bashkimi me familjarët është motivi më i dëgjuar nga individë të moshës së mesme." Kam djalin me nusen në Tiranë. Mosha ime dhe e gruas time tashmë ka nevojë për dikë që të kujdeset. Nuk mundemi më të përballojmë cdo gjë të vetëm në fshatin tonë"- shton një zotëri rreth të 70-tave, marrë në pyetje kalimthi.. (Ku e more këtë zotëri? Ka emër?)

Po, ka edhe nga ato individë ose familje që kanë mundësi ekonomike shumë të mira në qytetin e tyre, por mundësitë në atë vend janë tepër të kufizuara dhe nuk ia lejojnë arritjen e kënaqësisë dhe dëshirave që ata dëshirojnë. Në këtë pikë, dëshira për një jetë luksoze i bën ata të përqafojnë kryeqytetin e Tiranës

Shifrat

Sipas projeksionit të popullësisë dhe planit të zhvillimit për kryeqytetin e Tiranës, numri i popullësisë, pas 10 vjetësh parashikohet të jetë në mbi 1.5 milionë banorë. Në rast se shtimi i popullësisë për qytetin e Tiranës do të rritet me një mesatare me 7.5 % rritje në vit, atëherë në vitet 2007-2017 ajo parashikohet të shkojë deri në 1.3 milionë banorë dhe në vitin 2019 do të arrijë në mbi 1.5 milionë banorë.

Specialistë kanë vlerësuar se ritmi i rritjes së popullsisë së Tiranës është më i larti në botë, me 7-8 për qind në vit. Zhvillimi i madh që ka marrë kryeqyteti shton problemet e strehimit dhe synon nxitjen e një zhvillimi më të madh ekonomik.

Ndërtimet

Me rritjen e popullësisë së kryeqytetit shënohet dhe rritja e ndërtimeve që ka një shtrirje në të gjitha zonat. Të dhënat zyrtare tregojnë se Tirana zgjerohet çdo vit me ndërtime, të cilat zënë rreth 200 hektarë tokë. Zgjerimi i kryeqytetit në sajë të ndërtimeve llogaritet se kap shifra të larta të tokave të zëna dhe të shtimit pa kriter të ndërtesave që nuk kanë një projekt të caktuar, si zona në qendër apo periferike të një qyteti të madh europian.

Nga censusi i vitit 2011 mësohet se nga rreth 598 mijë ndërtesa totale për qëllime banimi në Shqipëri, 31,3 % e tyre ndodhen vetëm në qarkun e Tiranës. Janë shtëpi individuale, të përbëra nga një kat dhe vetëm me një banesë. Për shkak të projekteve të ndryshme për rregullimin e territorit të Tiranës, një pjesë e këtyre ndërtimeve janë prishur ose rrezikon të prishen pasi janë pa leje, për shkak të planit zbatues të projekteve të bashkisë për kryeqytetin. Ndërsa një pjesë e tyre i janë nënshtruar rregullave ligjore, duke u shpronësuar dhe mjaft të tjerë i kanë legalizuar banesat.

Në Tiranë, për të ndihmuar fëmijët

Në foto: Familja Mehmetaj. Fotot: Najada Fosa

Kujtim Mehmetaj ka ardhur prej katër vitesh në Tiranë duke lënë Kuçin e Vlorës, fshatin në të cilin u lind dhe u rrit. Vlonjati jeton bashkë me familjen e tij prej pesë personash në rrugën Don Bosko në Tiranë. Një lagjë e populluar ndjeshëm këto vitet e fundit me të ardhur nga rrethe të ndryshme të vendit.

Familjarët janë Kujtimi, i zoti i shtëpisë, gruaja e tij Violeta, djali Landi, nusja e djalit Marsela bashkë me fëmijën e tyre Noel, i cili është vetëm 8 muajsh.

Jetojnë në një shtëpi private ku përmban të gjjithë nevojat bazë për të jetuar normalisht një familje. Lagja përbëhet nga një komunitet heterogjen me familje të ardhura nga fshatra dhe qytete të ndryshme të Shqipërisë, përveçse Tiranës.

Z.Kujtim, cila ishte arsyeja që ju shtyu të linit vendin tuaj të lindjes, ku ju keni kaluar një pjesë të mirë të viteve?

Deri në moshën 54-vjecare kam jetuar vetëm në fshatin tim Kuç, një vend që mund ta quaj "perlë e natyrës shqiptare". Në atë fshat të vogël u linda, u rrita dhe krijova familjen time. Po me vitet dhe jeta ndryshon, rrethanat në të cilat gjendesh të bëjnë të marrësh vendime ku njeriu i mendon se janë më pozitive për jetën në vazhdim. Jetën drejt Tiranës unë dhe ime shoqe Violeta filluam ta mendonim që kur djali ynë Landi nisi universitetin, por rrethanat akoma nuk ishin pjekur. Ne akoma nuk ndjeheshim gati të përballeshim me kryeqytetin..

Në bashkëbisedim futet djali….

Jeta në Tiranë ishte shumë e vështirë për një student. Unë po shkollohesha në Akademinë Ushtarake. Jetoja në një garsoniere bashkë me një shokun tim patriot. Ndanim qiranë bashkë. Por kjo situatë zgjati pak, pasi unë në atë kohë njoha Marselën. U dashuruam të dy në shikim të parë dhe unë këtë lidhje doja ta zyrtarizoja në familjen time dhe kështu ndodhi. Nuk zgjati një vit nga njohja jonë dhe ne u fejuam. Pas fejesës e ndjemë nevojën për të qënë pranë njëri-tjetrit dhe vendosëm të gjenim një apartament të vogël për të jetuar bashkë. Vazhduam jetën në çift, por sytë i kishim te familjet tona, sepse ne ishim vetëm dy studentë të papunë që kishin nevojë të vazhdueshme ekonomike nga prindërit..

Ju më thoni se pavarësisht se tashmë kishit vazhduar jetën tuaj në Tiranë, ekonomikisht ju mbante familja. Cili ishte burimi i këtyre të ardhurave? A ia dilnin prindërit të mbanin dy familje?

Ndërhyn babai….

Unë dhe gruaja ime punonim shumë në fshat. Kishim shumë bagëti. Merreshim me kullotjen e dhive dhe deleve. Gjithashtu kishim edhe pula. Nga prodhimtaria e tyre, ne arrimin të gëzonim një jetë të mirë ekonomike si një familje malësore. Prodhonim djathë, bënim mjaltë, raki etj. Me këto të ardhura ndihmonim djalin tonë. Por pas fejesës së djalit, ne vendosëm përfundimisht të vinim në Tiranë..

Cila ishte arsyeja që ju shtyu të braktisnit gjithçka? Ishte vendim i juaji z.Kujtim apo i sforcuar edhe nga djali?

Përgjigjet djali..

Po, ishim ne që ia kërkuam të vinin dhe të jetonin me ne. Kishim shumë nevojë për ndihmën e tyre. Tashmë ishim në vitin e fundit të shkollës dhe

ngarkesa ishte e tepërt si për mua, ashtu edhe për Marselën. Nuk na dilte koha as të gatuanim… Ja kërkuam me ngulm që të na ndihmonin…

Vazhdon z.Kujtim…

Dhe kështu vendosëm. Viti 2010 ishte viti i ndryshimit të jetës tonë. Duhet të bënim detyrën tonë si prindër, deri sa fëmija jonë të stabilizohej me punë. Shitëm bagëtitë tona për të siguruar sadopak të ardhura, për aq kohë sa do rrinim pa punë. Pasi erdhëm në Tiranë, djali gjeti shtëpinë, në të cilën ndodhemi sot, pasi apartamenti ku ndodheshin përbëhëj vetëm nga një dhomë dhe një guzhinë.

"Kanë kaluar 4 vite nga dita që jemi transferuar në Tiranë. 4 vite të mbusha me ndodhi dhe ndryshime në jetën tonë, si: martesa e djalit, ardhja në jetë e nipit tonë të parë Noel etj., por mendja dhe shpirti im ngelet në fshatin tim"- shton Kujtimi..

I drejtohem nuses së shtëpisë Marselës: A jeni e lumtur me jetën në Tiranë? Si është jeta juaj këtu?

Tashmë u bëra 3 vite që kam mbaruar shkollën e lartë për ekonomik-kontabilitet. Që ditën kur mora dipmomën në dorë , kam shpërndarë CV time në çdo vend punësimi, por pa sukses. Sot gjendem në Call Center. Vërtetë nuk ndjehem e plotësuar profesionalisht, sepse investova 5 vite të jetës time në atë shkollë, por ama ndjehem e kënaqur ekonomikisht. Unë dhe Landi u bëmë prindër të Noelit para 8 muajsh dhe do bënim çdo gjë vetëm që vogëlushit tonë të mos i mungojë asgjë. Tashmë u bëmë vite që jetojmë në Tiranë. Unë dhe Landi kemi krijuar shoqërinë tonë, dalim, dërfrehemi, kënaqemi. Nuk e ndjejmë aspak mungesën e fshatit ku kemi lindur dhe kaluar fëmirinë. Në Tiranë ndjehemi të lirë, larg mentalitetit të theksuar, zakoneve e traditave tona të cilat për një të ri në ditët e sotme është e vështirë të ambientohet. Në Tiranë është çdo gjë ndryshe. Mendojmë se e ardhmja jonë do të jetë këtu..

Pyetje drejtuar Landit: Po për ju Landi ka qenë e vështirë gjetja e punës në Tiranë?

Ndyshe nga Marsela un pata pak më shumë fat , pasi u bëra 2 vite që punoj në Gardën e Republikës. Aty ndjehem mirë, edhe pse e mira nuk ka fund dhe njeriu dëshiron dhe lufton në maksimum për veten e tij. Dua ta shikoj jetën me pozitivizëm, duke menduar që jam i ri dhe kam jetën përpara. Shpresoj që në të ardhmen të gjej një pozicion më të mirë, pse jo.

Ju z. Violeta, si ndjeheni në Tiranë?A jeni ambientuar tashmë?

Jam e lumtur që në një farë mënyre fëmijët kanë marë drejtim. Djali është në punë, edhe pse do dëshironim që pagesa mujore të ishtë më e mirë. Nusja edhe pse jo në profesionin e vet, por ama sjell të ardhura në shtëpi dhe sot për sot që kanë fëmijën e vogël kjo ka rëndësi për to, sa më shumë të ardhura ekonomike.

Un dhe im shoq jemi të papunë, fatmirësisht kemi një dyqan në fshatin tonë, të cilin e kemi lënë me qera, ku marim një rrogë mujore. Këtu në Tiranë nuk njohim njeri. Ndjehem e mbyllur në mes të katër mureve. Mosha ime ka nevojë të ndërrojë një fjalë, të pi një kafe dhe të ndjejë se kam dikë pranë, një njeri të vetin.., por Tirana nga kjo anë qenka shumë kursimtare. Çfarë të bëjmë?! Do bëjmë durim, derisa Noeli i vogël të rritet e të bëhët për të shkuar në kopësht… Tirana nuk është për në, Tirana është për të rinjtë guximtarë dhe punëtorë si fëmijët tanë.


Landi dhe Marsela me Noelin

Me këtë që po thoni po më bëni të kuptoj largimin tuaj nga Tirana apo gabohem…?

Fjalën e merr z. Kujtim..

Po po ... bashkë me gruan vendosëm të vinim në Tiranë për t'i ndihmuar fëmijët për aq kohë sa ato do të kishin nevojë për ne. Më pas të kthehemi në vendin tonë... Kam nevojë për fshatin tim. Duam lirinë tonë. Kushtet tona. Njerëzit tanë. Është e pamundur të integrohemi sot në këtë moshë në kryeqytetin e Tiranës. Së shpejti ne do kthehemi në fshatin tonë të dashur, në atë fshat që ma ka bërë koka bam dhe aty dua të vdes!

Rastësisht kryeqytetas

Drita Merkoçi duke folur për "Objektiv"

Besnik Merkoçi bashkë me familjen e tij janë shpërngulur që prej 15-vitesh nga Xhavzotaj i Shijakut në Tiranë. Familja Merkoçi janë 4 anëtarë: Besniku, bashkëshortja e tij Drita dhe dy djemtë e tyre, Andi 28 vjeç dhe Klajdi 24 vjeç. Apartamenti është i kompletuar me një modern të kohëve të sotme.

Të parës që i drejtohemi është zonja Drita. Më vjen mirë që shoh kaq pozitivizëm tek ju. Më bëni të kuptoj që jeni tepër e lumtur nga jetesa juaj në kryeqytet. Por fillimisht jam kurioze të di, kush ishit ju para se të vinit në Tiranë?

Buzëqesh nën zë…Lërmëni të kthehem mbrapsht në kohë për pak çaste. Isha një shëpijake. Dilja vetëm te nëna ime dhe pija kafen e mëngjesit me komshinjtë e lagjes. Një jetë monotone, ku çdo ditë përsëritej i njëjti avaz. Kishim një biznes të vogël familjar, një dyqan të vogël me fruta dhe perime. Me menaxhimin e tij merrej im shoq. Ishte e vetmja e ardhur në familje. Fëmijët i kishim të dy në shkollë, në tetëvjecare.

Si ju lindi ideja për të ardhur ne Tiranë..?

Ardhja në Tiranë ishte një rastësi, ose më mirë "na trokiti fati në derë" . Vëllai i bashkëshortit tim zotëronte një supermarket të madh në Tiranë, por para pak kohësh ai kishte futur dokumentat për të ikur në Amerikë. Ishte data 20 prill 1999, kur ai na telefonoi për të na thënë që i kishin dalë dokumentat dhe që për 1 muaj do largohej. Atë natë na propozoi që im shoq dhe unë të merrnim në dorë menaxhimin e supermarketit….

Mes konfuzionit dhe dëshirës për një jetë më të mirë vendosëm të mernim përsipër këtë hap. E menduam gjatë të dy. Ajo punë do na sillte të ardhura për një jetesë më të mire, gjithashtu edhe e ardhmja e fëmijëve tanë do të ishte shumë më e mirë nga ç'prisnim në Shijak...

Fillimisht gjetëm një shtëpi me qera tek "21 dhjetori". Me datë 26 qershor 1999 u transferuam në Tiranë, pasi pritëm deri sa fëmijët mbaruan shkollën. Muajt e verës u integruam e gjithë familja, bashkë me fëmijët në supermarket, pasi nuk donin të shpenzonim me punonjëse. Punuam të gjithë derisa fëmijët filluan shkollën në Tiranë. Për pesë vite me radhë, unë punova me tim shoq në supermarket. Puna po ecte goxha mirë. Ne po arrinim të kursenim aq shumë të ardhura saqë tashmë po mendonim të blinim një shtëpi...

Po djemtë si e përjetuan ardhjen në Tiranë?A ishin të kënaqur, apo u mungonte vendi i tyre?

Fillimisht e patën të vështirë të ambientohen, pasi nuk njihnin njeri. U mungonte shoqëria që kishin lënë pas... Muajt e parë jemi kthyer shpesh në Shijak për të takuar të afërmit tanë dhe fëmijët, shokët e tyre. Më pas, këtu zunë shoqëri të re. Nuk ankoheshin për vetminë e tyre. Vitet kaluan dhe ne sot gjendemi në shtëpinë tonë .Pas kaq vitesh punë arritëm të blinim këtë apartament me tre dhoma e një kuzhinë. Jam tepër e gëzuar që më në fund mund të fle e qetë, pa menduar fundin e muajit të qerasë. Ishte një stres në vete!

Andi, djali i madh ka mbaruar shkollën e lartë për menaxhim biznesi, me nota të shkëlqyera, ndërsa Klajdi mbaroi për shkenca politike. Jam tepër e kënaqur për arritjen e fëmijëve të mi.

Po ju sot si ndjeheni pas kaq vitesh në Tiranë, a jeni integruar? Me se merreni?

Unë jam tepër e lumtur. Tirana na hapi dyert e mbarësisë. Falë Zotit jemi shumë mirë ekonomikisht. Unë kam krijuar shoqërinë time. Kam njohje nga vitet e punuara në supermarket. Gjithashtu me komshinjtë e mi në pallat kemi një marrëdhënie shumë mirë miqësore.

Momentalisht po rri në shtëpi, duke qenë se në supermarket kemi marrë punjonjës dhe nuk nevojitet ndihma ime, por edhe burri bashkë me fëmijët kanë nevojë për përkujdesje, tani që janë të tre në punë.

Nga Elta Liksenaj

Ata janë kampionë, shteti u bën "mat"

Pak mund ta dinë që termi "shah mat" vjen nga persishtja dhe do të thotë: Mbreti është i pambrojtur,i pazoti! (The king is helpless) ndërsa rrënjët morfologjike janë nga arabishtja: mata - vdiq.

Por ta bësh një mbret të dorëzohet në një tabletë shahu mund të jetë po aq e vështirë sa në një fushëbeteje të vërtetë. Madje mos më shumë…nësë atje duhet forca e shpatës, në artin e shahut nuk të bën punë tjetër, veçse zotësia dhe shkathtësia e mendjes.

Suzana Kërçiku është nxënëse në klasën e nëntë të shkollës "Fan Noli" por në të njëjtën kohë është një nga pjesëmarrëset e Kampionatit të Sivjetshëm të Shahut. Kjo do të jetë një ndër përballjet e radhës në "betejën e hapur të mbretëreshës dhe ushtarëve".

Suzana na tregon sesi filloi të merrej me shah në moshën 7-vjeçare dhe shumë shpejt shahu, u shndërrua në pasionin e saj dominant. Nëse shumicën e bashkëmoshatarëve të saj i shikon të zhytur në botën virtuale të rrjeteve sociale apo video-lojrave, Suzit 15-vjeçare i mjafton një kuti me gurë të zbrazur shahu, që në shiritin e kujtesës të regjistrohen gjurmëza të sfidës së ardhshme.

Kur keni filluar të luani për herë të parë shah?

Fillimet e mia në shah kanë qënë në moshën 7-vjeçare pas mbarimit të klasës së parë.

Ishte dëshira juaj të praktikonit shahun apo shtysa e familjes?

Në fakt ishte shtysë e babait tim, pasi ai kishte dëgjuar për këtë sport dhe e pëlqente shumë duke dashur që unë të vazhdoja në këtë rrugë.

Si filluat të luanit?

Fillimisht u regjistrova në një kurs profesionist diku në zonën ku banoja dhe pas kësaj ushtrohesha cdo ditë nga pak

Në cfarë kompeticionesh keni marrë pjesë deri tani? A mund të na përmendi disa prej tyre?

Kam marrë pjesë në shumë kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare. Vecoj Kampionatin e Shahut për të Rinj, Kampionatin e Femrave, atë Individual etj. Tashmë prej 7 vitesh kam qënë pjesëmarrëse e cdo kampionat me qëllim jo vetëm për të fituar por edhe për të zhvilluar më tej aftësitë e mia.

Çfarë mund të na thoni për kompeticionet ndërkombëtare?

Përgjithësisht garat e shahut i kam zhvilluar në vëndet ballkanike por edhe në ato europiane. Kemi luajtur në Turqi, Bullgari, Greqi,Slloveni, Kosovë etj.

A mund të na veconi garën më të fortë?

Gara të forta ka pasur shumë, që kanë zgjatur edhe mbi 4, 5 orë. Përmend këtu kur kam marrë cmimin e parë duke u shpallur kampione shahu për grupmoshat 0-18, ku ky ka qënë cmimi me i lartë që kam marrë njëkohësisht edhe gara më e vështirë. Përballë kisha një konkurente ruse e cila po ashtu ishte mjaft e aftë. Ndërsa gara më e lehtë ka qënë ajo e shkollave të Tiranës.

Ju thatë që keni qënë në shtete të ndryshme për të marrë pjesë nëpër olimpiada shahu e kompeticione. Kush ju ka financuar?

Federata Shqiptare e Shahut mbulon vetëm gjysmën e shpenzimeve, pjesa tjetër gjithmonë është mbuluar nga familja ime. Ndërkaq që edhe shpërblimet nëpër kompeticione janë shumë simbolike krahasuar me kolegët tanë në shtetet e tjera ku këtij sporti i jepet më shumë prioritet.

Doni të vazhdoni më tej në ushtrimin e këtij sporti?

Megjithëse shpërblimi është simbolik, unë dua ta vazhdoj pasi është një pasion i hershëm i imi.

Cfarë cilësish duhet të ketë një person që ushtron shahun?

Një person që merret me shah nuk ka pse të ketë ndonjë cilësi të vecantë por duhet të jetë shume i organizuar, i qetë dhe i përqëndruar. Do të thoja disiplinim në ushtrim dhe gjakftohtësi në përballje me kundërshtarin.

Keni menduar për profesionion tuaj të ardhshëm apo është ende herët?

Nuk kam menduar ende konkretisht por shpresoj që të ketë lidhje me pasionin tim të hershëm dhe ekzistues: Shahun.

Fillimet zyrtare të shahut shqiptar datojnë në maj të vitit 1933. Sporti i shahut në Shqipëri edhe pse zyrtarisht daton në vitin 1933, pa dyshim që është luajtur më parë. Në një botim të saj, Federata Shqiptare e Shahut, thekson faktin se gjurmët e shahut të çojnë në vitin 1910 dhe tek një emër: Abdulla Tirana nga Elbasani, ky i fundit e kishte mësuar shahun në Iranin e sotëm, në Persi.

Abdullai është edhe më i spikaturi i kohës së tij, teksa në vitin 1913, te kafeneja "Shkumbini", pranë portës së kalasë së Elbasanit u luajt publikisht edhe loja e parë.

Në janar të vitit 1933 "Federata Sportive", që varej nga Enti Kombëtar "Djelmënia Shqiptare" organizoi të parin "kampionat të Shqipërisë", ku morën pjesë tetë shahistë: Xhafer Çaushi (kampioni i parë kombëtar), Muhamet Vokshi, Muhamet Hoxha, Eqerem Stërmasi, Petro Martini, Ahmet Gashi, por dhe dy të huaj, një gjerman e një austriak. Kampionati u zhvillua nga data 6 deri më 15 mars 1933.

Kryetari i Federatës, Anton Mazreku, i dhuroi edhe trofeun e kampionit Xhafer Çaushit, një tavolinë artistike të zbukuruar me katrorët e shahut si dhe një takëm artistikë të gurëve të shahut, të punuara nga mjeshtri i drurit Angjelin Kurti, edhe ky një dashamirës shahu. Federata e Shahut u themelua, më 14 maj të vitit 1933. Petro Martini ishte kryetari i parë i federatës, e deri në vitin 1939, këtë post e mbajtën edhe Mehmet Vokshi e Tom Truja.

Aktiviteti i shahut pas ndërprerjes për shkak të Luftës së Dytë Botërore, rifilloi në vitin 1946. Kampioni i parë i paslfutës është Gaspër Shoshi i 17 Nandorit të Tiranës, apo Tiranës së sotme. Kampioni i fundit, ai i vitit 2009, është Ilir Seitaj, që mbron ngjyrat e Butrintit.

Ndër kampionët më të mëdhenj janë Ylvi Pustina, Skënder Çarçani, Fatos Muça, Vangjel Adhami, Esa Duraku, Bujar Hoxha, Sotir Qirjako, Llambi Qëndro, Shkëlqim Çela, Lorenc Rama, Altin Çela, Erald Dervishi, Dritan Mehmeti. Kampionati i parë ekipor u zhvillua në vitin 1969, ku kampion doli Dinamo.

Nga Altin Tufa

Biznes-arti i rrugës

Ekspozita e portreteve të gjalla të realizuara me mjeshtëri nga artisti i talentuar në fushën e pikturës, Endriol Vasili. Veprat e tij të papërsëritshme tundojnë çdo ditë qindra kalimtarë që kalojnë vë rrugën e Pedonales në Tiranë, ku ai ushtron artin e tij.

Në foto Endriol Vasili. Fotot: Altin Tufa

Endriol, na tregoni pak për hapat e para?

Unë kam zgjedhur një mënyrë krejt ndryshe për të prëzantuar apo për të bërë të njohur talentin tim njerëzve. Zgjodha që punën time, artin e pikturës ta kryeja në terren. Artin në rrugë e kam filluar në vitin 2010, diku nga liqeni, ku punova për rreth 1 muaj pastaj u detyrova dhe mora guximin të eksperimentoja në Durrës, atje punova përrreth 2-vjet. Fillova të punoja portretin e çastit dhe kopjimet e portreteve nga fotografia. Brenda një periudhe tremujore u bëra i njohur si artist realist-impresionist. Njerëzve u pëlqeu arti im. U riktheva sërisht në Tiranë, ku edhe sot e kësaj dite jetoj dhe punoj këtu.

Çfarë përshtypjesh krijonin njerëzit kur shihnin artin tuaj kur kaloni në rrugë? Cilat kanë qenë reagimet e para?

Punimet i realizoj me akuarel, me vaj, me laps, gravurat, pirografi dhe gdhëndie në allçi. Tani kam më shumë se dy vjet që po punoj me teknikën "dry brush" (penel të thatë). Kam sjell teknikën penel i thatë që kam mësuar nga artistët rusë dhe mundohem të përfeksionoj artin tim me teknikat më të fundit të frymëzuara nga piktorët me famë të kohës si: Yakov Dedyk, Igor Kazarin, Vladimir Volegov, etj. Emocioni që ndjej kur punoj shprehet mjaft bukur dhe me origjinalitet dhe në pikturë, por reagimet e para të njerëzve janë pak të çuditshme. Herë herë të nënvlersojnë duke e paragjykuar pa e njohur mirë artin, shprehen se: "Kjo punë është e stampuar apo nuk ka mundësi ta keni bërë ju". Tani kanë kaluar vite dhe arti është bërë më realist, por reagimet janë pothujse njëlloj, por nga njerëz të ndryshëm.

Sa varioinë çmimet e punimeve tuaja, si priten ato nga klientët?

Çmimet janë për një person dhe varioinë nga 6 500 lekë deri në 12 000 mijë lekë për një punim mesatar. Ka raste që njerëzit tremben nga çmimi, por ka edhe nga ata që e shohin shumë lirë punën, pasi mund ta dinë se ç'mundim dhe përkushtim kërkon. Piktura është diçka qejfi, njerëzit e bëjnë apo blejnë një pikturë për qejf, nuk e bëjnë për hall, pra ai që ka të ardhura e bën një pikturë të tillë.

A ju frymëzon rruga më shumë se studioja apo peizazhe të tjera?

Po ka ndryshim, sidomos kur isha në

Durrës atmosfera e detit më frymëzonte akoma më shumë. Por një avantazh tjetër që dua ta theksoj se, kur punon në terren është ndryshe nga studio, kur ushtron artin në rrugë ke kontakte apo komunikim me shumë njerëz, afron klientelë, ke zgjerime idesh, duket më e besueshme si punë, njihesh më shumë. Madje sot, teksa një grua po kalonte me vajzën dhe pa punimet që unë kam relaizuar, u mahnit dhe e la vajzën aty për t'i realizuar një portret në moment. Pasi 3-4 orësh që e përfundova, zonja u lumturua dhe e pëlqeu shumë, mbeti mjaft e kënaqur. Kjo ndodhi për shkak se unë punoja në terren dhe jo në studio, andaj unë sugjeroj që pedonalja të mbushet e tëra me piktura nga piktorë të ndryshëm, siç janë edhe sheshet në Venezia, Firence, Francë, etj.

Çfarë pëlqeni të realizoni më shumë, portretet apo peizazhet. Cili ka qenë punimi më i vështirë?

Më shumë tek portreti, më ka frymëzuar dhe jam aftësuar shumë. Ndërsa peizazhet i punoj shumë rrallë, më shumë për t'u relaksuar. Synim të përditshëm kam vetëm portretin, për atë jepem më shumë. Punimi më i vështirë ka qenë një portret i madh, rreth një metër, i punuar me teknikën penel i thatë. Një portret që e kam realizuar para dy viteve, i bërë me ngjyra. Punimi me ngjyra është më i vështirë se ai bardhë e zi. Punimi është kryer nga mëngjesi deri nga ora 11 të darkës, jam shkëputur vetëm për të ngrënë diçka apo për të kryer nevojat personale, dhe asnjë lloj shkëputje tjetër. Pjesa më e madhe e njerëzve i kërkojnë punimet të kryera bardhë e zi për shkak të çmimit që kanë, ndërsa ato me ngjyra janë shumë të rrallë.

A ju japin ide kalimtarët?

Janë të shumtë njerzit që japin ide. Disa janë pedagogë ose disa të tjerë që kan mbaruar Akademinë e Arteve, por që nuk kanë lidhje me punën që bëj unë. Ndaj artit realist ka dhe një lloj smire, shpesh ndodh që të japin këshilla kot pa lidhje për të prishur punë, por ka edhe nga ata që kanë sy për këtë punë dhe më japin ndonjë këshillë teksa kalojnë pranë. Gjithashtu edhe ime shoqe, më ndihmon shumë duke më sugjeruar shumë ide.

A keni dëshirë që ta lini trashëgimi artin tuaj?

Po, por tani për tani nuk kam fëmijë, kur të kem përse jo. Në fakt unë kam filluar që në qytetin tim të lindjes, në Kuçovë duke përgatitur 20 nxënës për liceun artistik. Sot për sot i jap mësim vetëm dy nxënësve, për hobi. Jam i kënaqur që ua përcjell artin dhe talentin tim nxënësve të mi. Një pjesë e mirë e tyre vazhdojnë ende shkollën, liceun, akademinë e artitekturën. Disa të tjerë e kanë përfunduar.

Çfarë këshille jepni për artistët e rinj?

Punë dhe vetëm punë. Duhet të punojnë shumë, kjo është më e rëndësishmja.

HËNA E PLOTË BEDËR UNIVERSITY

Në emër të vlerave!

Master në

Master i Shkencave në Drejtësi
E Drejtë Penale / E Drejtë Ndërkombëtare
Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit
Gazetari / Marrëdhëniet me Publikun
Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame
Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Master i Shkencave në Përkthim dhe Interpretim
Master Profesional në Mësuesi,
Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm
Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji
Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor,
Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke

Bachelor në

Drejtësi
Shkenca Komunikimi
Shkenca Islame
Gjuhë dhe Letërsi Turke
Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji
Arsim Parashkollor dhe Fillor

Adresa: Rr "Jordan Misja",Tiranë-Shqipëri
Kontakt: Tel + 355 4 24 19 200 Cel :+355 67 34 27 00 e-mail: info@beder.edu.al

Nga Andi Pepa

Maska virtuale, një realitet i kohës sonë

Kush më pak e kush më shumë, secili prej nesh është përdorues i teknologjisë. Tani është bërë e pashmangshme. Sapo zgjohemi, gjëja e parë para se të lajmë sytë është të kontrollojmë Iphonin ose Tabletën tonë. Koha që jetojmë, e quajtur si "epoka e teknologjisë" është domosdoshmëri në jetën e përditshme, madje shfrytëzimi i saj është një lehtësi dhe kursim kohe.

Për shembull, tani nuk na duhet më të shkojmë në dyqanet e kompanive celulare që të blejmë kartë rimbushëse, por menjëherë e rimbushim kartën nga laptopi ynë, pavarësisht sa mund të jetë ora. Për këtë na mjafton vetëm lidhja e internetit dhe ca para në llogarinë tonë në bankë. S'është as nevoja që të shkojmë në sportelet e CEZ-it që të paguajmë faturat e energjisë elektrike. Por, përsëri me një "click" mund ta përmbyllim këtë detyrim për jo më shumë se 2 minuta. Për ata që udhëtojnë shpesh jashtë shtetit nuk është e nevojshme të shkojnë në agjencitë e udhëtimeve për të blerë biletë, por shumë lehtë e blejnë biletën edhe nga shtëpia, nëpërmjet Smartphonëve. Siç e pamë më lartë, përdorimi i teknologjisë është i dobishëm në disa raste. Në disa raste të tjera edhe e pashmangshme, por kjo situatë mund të na kthehet në disfavorin tonë. Ajo bëhet shkak për probleme në jetë, në qoftë se nuk dijmë ta kontrollojmë këtë "mirësi". Interneti na ndihmon të komunikojmë, të informohemi, të bëjmë blerje, shitje, pagesa online etj., por përdorimi i pakujdesshëm i tij mund të na krijojë varësi. Këtu fillon problemi. Ata që krijojnë varësi nga internetit mund t'i klasifikojmë në pesë grupe. Internet i bën njerëzit më të hapur për komunikim, më social, por në të njëjtën kohë i izolon ata nga bota e jashtme dhe zhduk komunikimin fizik.

Në grupin e parë futen të fiksuarit pas faqeve erotike, një fenomen që në përgjithësi shihet te meshkujt. Në grupin e dytë futen ata persona që kërkojnë shokë/shoqe. Të tillë janë ata janë të dhënë pas lidhjeve virtuale (cyber relationship). Në grupin e tretë futen personat e dhënë mbas kumarit online, por edhe ata që bëjnë blerje online. Në grupin e katërt futen ata persona që harxhojnë orë të tëra duke lundruar në internet, për të gjetur një informacion kalojnë nga një faqe interneti në tjetrën dhe marrin kënaqësi me këtë që bëjnë. Këta janë të apasionuarit pas informacionit. Dhe në grupin e pestë futen ata persona të fiksuar pas lojërave kompjuterike, të cilët harxhojnë orë të tëra në kompjuter për të përfunduar lojën (në këtë grup mund të futen fëmijët, adoleshentët dhe pse jo të rriturit).

Personat e fiksuar pas teknologjisë harxhojnë orë të tëra në kompjuter apo pajisje të ngjashme dhe gjatë kësaj kohe ata e shohin të padomosdoshme të komunikojnë me pjestarët e tjerë të familjes, por mbyllen në botën e tyre virtuale, krijojnë shoqërinë e tyre virtuale dhe fillojnë të marrin kënaqësi nga kjo që bëjnë. Me kalimin e kohës, te këta tipa fillojnë të shfaqen shenjat e stresit dhe më vonë depresioni. Fillojnë ta ndjejnë veten të pavlerë, si edhe krijojnë fobi ndaj komunikimit fizik.

Personat që nuk kanë vetëbesim fillojnë të krijojnë identitet virtual ku mund ta shfaqin veten e tyre me egon ideale që mund të arrijnë, duke u ndjerë më mirë, më i fortë dhe me më shumë vetëbësim. Tipa të tillë shfaqen në website, dhoma chati të ndryshme, si "lektorë" dhe poet me komentet e tyre, por në jetën e përditshme nuk lidhin dot dy fjalë. Në të vërtetë, ata i vendosin vetes maskë virtuale dhe fshihen pas kësaj maske, duke e treguar veten më të mirë seç janë. Por, me kalimin e kohës ky na shfaqet si problem shumë i madh, sepse te personi kemi dyzim personaliteti, virtual dhe real. Në këtë mënyrë, personi futet në dilemë se cili është personaliteti i vërtetë i tij.

Rol kryesorë në shpëtimin nga vartësia e teknologjisë është familja, pjestarët e familjes duhet ta shtojnë komunikimin midis tyre, duhet të konsumojnë më shumë kohë bashkë dhe nuk duhet të lënë hapsira për aktivitete të padobishme. Nëse do te jepnim disa këshilla për ata që kanë krijuar varësi nga internet do te ishin: Studioni veten për një kohë të shkurtër dhe shihni se në cilat orë të ditës përdorni më shumë internetin. Më vonë, në këto orë vendosni të bëni gjërat që pëlqeni më shumë, të shkoni në palestër, të takoheni me shokët, të lexoni një liber, etj. Në këtë mënyrë, ju do të mund të largoheni sadopak nga interneti dhe me kalimin e kohës do të merrni rezultate më të frytshme.

Nga Alba Boriçi

Copëza nga jeta e goranëve të Kukësit

Krahina e Gorës shtrihet në trekëndëshin Kukës-Kosovë-Maqedoni. Në Shqipëri, ajo ndodhet në pjesën lindore të Kukësit. Është krahinë me bujqësi dhe blegtori të zhvilluar. Është dokumentuar relativisht herët si vendbanim.

Në fillimet e saj, përpara pushtimeve serbe, kjo krahinë është quajtur Malësi. Pas ardhjes së serbëve, për qëllime shoviniste, iu vu emri Gorë, që nga sllavishtja do të thotë malësi.

Ndryshimi i emrit nga Malësi në Gorë shpjegon heshturazi historinë e kësaj krahine. Emërtimi Gora flet për atë që kërkonin të huajt për banorët e kësaj krahine: sllavizimin e tyre dhe zhveshjen e saj nga atributet e një vendi autokton. Por, thelbi, kuintesenca, rrënja e kryefjala e saj mbetet Malësi.

Gjeografikisht, është Malësi. Në Kukës, në ndërgjegjjet e zemrat e goranëve, ajo mbetet vendbanimi i tyre autokton shqiptar.

Kultura gorane është shumë e pasur. Ajo mund të shihet në disa rrafshe:

Kultura folklorike

Kultura folklorike e Gorës është e mbushur me animizma, kafshë të cilat mund të jenë miq ose armiq me njeriun. Me këto shpjegohet edhe karakteri pagan i folklorit. Në disa këngë folklorike, ujku është mik me njeriun. Armiku i njeriut e më kryesori është Djalli, Shejtani, që goranët e quajnë "qoftëlargu, "da je da leko" (Mbështetur te Qemal Mataj, "Njohja e historisë apo kërkesa politike për Gorën dhe goranët", Kukës, 1991.).

Shejtanin e trajtojnë si qenien më keqbërëse e faktorin kryesor të humbjes së rrugës së drejtë. Në mitologjinë gorane njihet përbindëshi ("Dërzhi"), dynjaja. Këtu, kuptimi pagan është shpirtëzimi i natyrës. Përbindëshi Derzhi përfytyrohet si qenie që mban tokën, është gati si perëndi e mitologjisë greke. Por, ajo fiton edhe një kuptim fetar. Goranët i kanë dhënë trajtë monoteiste edhe mitologjisë së tyre pagane për të keqen. Ja për shembull, nëse do ta merrnim figurën e qoftëlargut dhe të përbindëshit Dërzhi, si sjellës të së keqes, edhe sipas parimit fetar kemi aksiomën: "dunjaja të mashtron….shejtani do ju afrohet para, mbrapa, majtas, djathtas…"

Vallet gorane, muzika tradicionale gorane e veglat muzikore janë një pasuri e vyer e kulturës folklorike. Notat muzikore që vijnë përmes fyellit, çiftelisë, curla, dajres, gajdjes e më së voni, edhe përmes gërrnetës e që shoqërojnë vallet, sjellin madhështinë e kulturës muzikore-folklorike të krahinës.

Kultura fetare

Kultura fetare e kësaj zone ka evoluar në etapa historike. Në fillimet e saj, kjo kulturë ka qenë pagane.

Gradualisht, rryma e historisë e solli Gorën në valët e krishterimit. Më pas, te islami. Gjatë kohës së islamizimit, nga turqit ata morën emrin torbeshë.

Gjuhësisht, "Torbeshë" është fjalë e përbërë. Ajo përbëhet nga dy fjalë- tore (e afërt me fjalën turke dort, "katër") dhe besh (fjalë turke që në shqip do të thotë pesë). Sipas Qemal Matajt, emri torbesh shpreh statistikë fetare për islamizmin e goranëve: katër a pesë në ditë përqafonin fenë islame. Por, studiuesi Mehmet Hoxha mendon ndryshe. Në librin e tij "Gora dhe goranët" ai thotë se ky emër është në analogji me emrin pagan. Goranët e kanë ndërruar fenë katër a pesë here, për të qenë më në fund musliman. Përtej këtyre thënieve, goranët janë njerëz me parime të larta fetare. Rrjedha historike ka treguar se ata nuk janë islamizuar për përfitime, por vetëm për të lartësuar shpirtin.

Goranët konsideroheshin nga kisha si heretikë, ose si njerëz jashtë kulturës fetare, por ata ishin bogomilë. Kjo fjalë i kundërvihet asaj konsiderate të kishës. Në të folmen gorane, bogomil është fjalë e përbërë nga bogo (dashës) dhe mil (Zot), pra, dashës i Zotit, e ky ka qenë thelbi për këtë krahinë: të qënit dashës të vërtet të Zotit, të Atij që është vetëm Një. Ata janë bogomilë sepse përpiqen të ngjiten në shkallën shpirtërore të fesë. Ata patën përqafuan më herët krishtërimin e më pas islamin jo si klishe, apo si fe në kuptimin e saj kanonik, por për të qenë, vërtet BOGOMILË.

Kultura e veshjeve popullore

Veshjet popullore janë një pasuri tjetër e kësaj treve, ngjyrat e tyre kombinohen në mënyrë mjaft harmonike me njëra-tjetrën. Thjeshtësia e këtyre veshjeve e madhështon figurën e goranit e të goranes. Një panoramë mjaft të detajuar të këtyre veshjeve e ka dhënë Mehmet Hoxha në librin e tij, " Gora dhe goranët". Gratë gorane vishen më ndryshe nga vajzat gorane. "Vajzat gorane në përgjithësi mbajnë në kokë shami e qendisur me ojna (kitkel, temina, ruaza), në gushë duke mbuluar flokët dhe veshët.Jeleku i domosdoshëm, prej basme me ngjyra me astar këmisha nga kambriku i bardhë e gjerë poshtë dhe me mëngë të gjera, e qëndisur nga mëngët dhe në pjesën fundore të sajë. Një këmishë tjetër e veshur në trup, posht parës, mëndafshi, puplin ose me ngjyra, mëngët e së cilës duhet të mbërthehen.Nogajcë me dy pjesë: Kotef (brekushe të bardha), nogalke (pjesë e punuar me vegjë të qepura në fund të brekusheve), është pjesa që duket dhe e manipulueshme dhe për të rezistuar nga të ftohtit. Brezi i punuar në vegjë me ngjyra nga më të bukurat." (Mehmet Hoxha "Gora dhe goranët", f.166). Gratë kanë veshjen e tyre. Ajo dallon dukshëm nga ajo e vajzave. Ndryshe nga vajzat, ato veshin jelek me fije ari, fermele (jelek me fije ari që nuk mbërthehet). Veshja e grave ndryshon nga ajo e vajzave edhe në ngjyra. Nogajcën gratë e kanë me shumë ngjyra. Mbizotëron kryesisht e kuqja. Te vajzat është kryesisht e zezë. Gratë mbajnë veshur përsipër edhe terlikun e zi.

Ndërsa veshja e burrave "janë veshje të rënda prej shijaku…ato kanë benevrek, xhamadan (i mbërthyer dhe që qendron i hapur), mitana…markica, markiçe, gunjiçe (gjunjakë), kapësyzë: me mëngë të shkurtra, nuk mbërthehet përpara, ndërsa prapa i varet një pjesë, në rast shiu bëhet qylaf…(Mehmet Hoxha "Gora dhe goranët", f.168).

Këto janë veshjet popullore të goranëve. Ato përdoren gjerësisht edhe sot sidomos nëpër dasma, si krenari të vlerave të tyre kulturore.

E folmja gorane

Goranët e Kukësit, sikurse edhe gati e gjithë krahina e Gorës, flasin gorançe. Ajo është një dialekt i maqedonishtes. Shovinistët serbë kanë synuar, siç dihet, ta quajtur këtë krahinë pjesë të vetën. Si argument kanë përdorur gjuhën, duke e quajtur atë sllave e që sipas tyre përafron më shumë me serbishten. Por, argumentet shkencore të gjuhëtarëve kanë vërtetuar që kjo gjuhë është dialekt (ndoshta, arkaik) i Maqedonishtes, në simbiozë me shqipen. Formati i saj, karakteristikat sintaksore-morfologjike-fonetike vërtetojnë bashkëjetesën e shqiptarëve me popujt sllavë, kryesisht maqedonas. Nga pikëpamja fonetike, janë disa shkronja që përdoren masivisht në Gorë, por shumë pak, ose aspak në alfabetin maqedonas. Si shembull mund të marret shkronja (x), të cilën nuk e gjejmë në gjuhën sllave, por është e pranishme në shkrimin e gorës. Ndryshe nga gjuha sllave, përdorimi masiv i zanores (ë) dhe (një) është pasuri e kësaj të folme. Në të folmen goran ka fjalë që janë formime të gjuhës shqipe. Për shembull, fjala buzak është fjalë e prejardhur, e formuar nga rrënja buzë dhe prapashtesa –ak, e përdorur për dikë që ka buzë të trasha. Fjalë të tjera që vijnë nga shqipja janë: vullnet, vatra, shteg etj.

Në Gorë nuk është harruar e folura e tyre e nënës. Por, atje nuk lihet pasdore gjuha shqipe. Atje, që herët, janë hapur shkolla në gjuhën shqipe.

Gjuha gorane tregon bashkëjetesë e shkrirje në një të dialektit arkaik të maqedonishtes me shqipen, duke lindur pyetje mbi identitetin e tyre.

Pyetjet: Kush janë goranët e Kuksit? Janë serbë? Janë maqedonas? Apo janë vllehë? U përgjigjet mbartja dhe mësimi plot krenari e shqipes nga banorët e Gorës së Kuksit, e cila e zhvesh elementin gjuhë si faktor etniciteti në këtë vend. Goranët e Kukësit nuk mund të quhen maqedonas, as vllehë e as serbë, por shqiptar. Mbi të gjitha, ata mbartin një kulturë arkaike gjuhësore, tek e cila ka edhe shenja të shqipes,. Por, janë edhe ndjenjat e tyre mbi etnicitetin, të cilat këmbngulin fuqishëm për identitetin e tyre shqiptar dhe krenarinë e të qenit të tillë.

Borja

Midis fshatrave të Gorës brenda territorit të Shqipërisë është edhe Borja. Gjeografikisht, Borja shtrihet në pjesën verilindore të Shqipërisë e në pjesën lindore të Kukësit. Fshati ka dy lagje: lagjja e poshtme dhe lagjja e sipërme. Borja ka shkollë 9-vjeçare ku mësohet në gjuhën shqipe. Kjo është thuajse në qendër të Borjes. Shkolla është burim dijeje e në rastin konkret ajo është kthyer edhe në një vend ku ruhet më së miri gjuha shqipe. Lënia e shkollës në qendër të Borjes na duket se e tregon edhe më shumë vlerën dhe rëndësinë e dijes në këtë vend.

Çka është interesante në këtë vend, është Mali i Borjes. Lartësia e tij , krahasuar me malet përreth, e bën atë të quhet "mal në thonjëza". Konvencionalisht, duket sikur lartësia e tij është miti që shpjegon historinë e banorëve përgjatë kohës: Ata janë vetë Mali i Borjes. Sllavët apo pushtues të tjerë deshën ta shndërronin atë në kodër, por emri i tij ka qenë e mbetet: Mali i Borjes. Banorët e Borjes e kanë rritur vazhdimisht lartësinë e Malit të Borjes, duke e bërë këtë vend një mal krenarie.

Ata, si edhe shumica e goranëve, e në veçanti banorët e Shishtavecit shkëlqejnë në lojërat e sportet e alpinizmit, kryesisht në ski. Ata janë edhe sportistë të zotë në garat me kuaj.

Nga Hasan Bello

Si u sekuestrua ari shqiptar nga regjimi komunist

Aksionet më të mëdha për mbledhjen e arit të familjeve shqiptare që nga lufta e parë botërore deri në ardhjen e regjimit komunist

Historia e grabitjes së arit shqiptar fillon që në vitet e Luftës së Parë Botërore. Në bazë të studimeve të realizuar më parë nga studiues dhe kërkues të shumtë austriak, komanda ushtarake austro-hungareze kishte arritur në përfundimin se pothuajse çdo shqiptar posedonte në shtëpinë e tij sasi të ndryshme ari. Duke u nisur nga këto informacione, ajo mori masa duke prerë kartmonedha me kursin më të lartë valuator, se sa ky metal i çmuar. Shqiptarët të gjendur në kushte të vështira ekonomike si rezultat i luftës u detyruan që të blinin produkte të ndryshme ushqimore me ar, ose këtë të fundit ta shkëmbenin me kartmonedhën e re. Me forma të kësaj natyre një pjesë e mirë e arit shqiptar shkoi drejt Vjenës. Metoda të tilla përdorën pak a shumë edhe ushtri të tjera pushtuese deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Por, grabitjen më të madhe shqiptarëve ua bënë vetë shqiptarët.

Grabitja sistematike dhe konfiskimi i arit nga pasanikët shqiptar filloi me instalimin e regjimit komunist. Kështu, më 15 dhjetor 1944 u miratua ligji mbi ndalimin dhe eksportimin e arit dhe e metaleve me vlerë. Në nenin tre, për shkelësit e këtij ligji parashikohej dorëzimi i tyre në Gjykatës Ushtarake. Ajo mund të jepte dënime "të buta" 1-30 vjet dhe dënime të rënda, të cilat varionin nga burgim i përjetshëm deri në ekzekutim, në varësi të sasisë së arit që i kapej poseduesit. Kur kjo sasi ishte shumë e madhe, konfiskimit të sendeve të kapura i shtohej edhe konfiskimi i të gjithë pasurisë së tundshme dhe të patundshme, humbja e të drejtave civile dhe politike etj.

Me këtë legjislacion, shteti komunist synonte monopolizimin e ekonomisë dhe të vlerës monetare, grabitjen e arit nga pasanikët shqiptar dhe dobësimin e kësaj klase, e cila konsiderohej si rrezik potencial për regjimin e ri. Por, një arsye tjetër ishte edhe forcimi i monedhës shqiptare të Bankës së Shtetit, sepse rezerva bankare e arit do të mbështeste rezervat në franga dhe blerjen e mallrave nga jashtë Shqipërisë.

Me miratimin e ligjit mbi Bankën e Shtetit shqiptar më 13 janar 1945, grabitjes dhe konfiskimit të arit nga pasanikët shqiptar iu shtua edhe një mundësi tjetër, të gjitha sendet me vlerë dhe floriri i depozituar nga këta të fundit para çlirimit në Bankën Kombëtare nuk iu kthye më. Në kuadër të kësaj fushate sigurimi i shtetit dhe policia mori masa për mbikqyrjen, ndalimin dhe arrestimin e të gjithë personave që zotëronin sasi të ndryshme ari, kontrabandistëve dhe të atyre që përpiqeshin ta nxirrnin atë jashtë kufirit.

Një kontroll i rreptë u ushtrua dhe

mbi dhjetra e mijëra ushtarë italianë, që kishin ngelur si rob lufte dhe po ekstradoheshin drejt vendit të tyre. Ata u detyruan të linin çdo sasi ari dhe stoli që posedonin, para se të hipnin nëpër anije.

Më 25 prill 1946, për të përshpejtuar fushatën e grabitjes, Ministria e Financave i shpërndau të gjitha komiteteve ekzekutive të rretheve në një qarkore sipas së cilës, të gjithë atyre që kontribonin duke zbuluar dhe denoncuar poseduesit e arit t`u jepej 25% e vlerës së kapur. Monedhat e arit dhe valutat sapo të sekuestroheshin nga organet e sigurimit ose policia, duhet të depozitoheshin në ruajtje në degët e Bankës së Shtetit, në dispozicion të Gjyqit Ushtarak, derisa të jepej vendimi i formës së prerë. Në vitin 1946 u hartua dhe një projektligj mbi shkëmbimin e arit, por që shumë shpejt u anullua. Sipas këtij projektligji, të gjithë atyre që posedonin sasi ari u lihej një afat prej 30 ditë për ta këmbyer atë në Bankën e Shtetit. Këtu bënin përjashtim vetëm stolitë si dhe ndalohej shkrirja e tyre me qëllim për t`i kthyer ato në ar.

Me qëllim për t`i detyruar tregtarët dhe pasanikët shqiptar për të dorëzuar arin, atyre iu vu si kusht që të nënshkruanin një deklaratë për sasinë e poseduar. Këta të fundit fillimisht u munduan t`i shmangeshin statistikave ekzakte. Por, me anë të informatorëve, sigurimi i shtetit u angazhua për t`i zbuluar dhe arrestuar. Seksionet lokale të sigurimit gjatë kontrolleve nëpër shtëpitë e tregtarëve dhe pasanikëve sekuestruan jo vetëm monedha floriri, por çdo lloj takëmi dhe sende me vlerë, si bizhuteri ari, argjendi, sermi, unaza, varëse etj., por edhe komplete lugësh e pirunjsh të lara në ar ose argjend dhe antikuare.

Gjatë kësaj fushate u arrestuan me qindra e mijëra persona. Ata dhe familjet e tyre iu nënshtruan një presioni fizik dhe psikologjik të pashembullt në të gjithë botën komuniste. Shumica prej tyre u burgosën, internuan dhe u torturuan me forma nga më ç`njerëzoret. Aq e vrullshme ishte kjo fushatë sa që më 22 janar 1948 u miratua një ligj, i cili e uli në 5% sasinë e shpërblimit për personat që zbulonin dhe denonconin poseduesit e arit.

Kjo tregonte se organet e sigurimit të shtetit nuk e ndjenin më nevojën e tyre si tre vite më parë, kur atyre u jepej si shpërblim 25% e sasisë së konfiskuar. Megjithatë, për të mbledhur ndonjë monedhë apo sasi të vogël ari që i kishte shpëtuar "syrit vigjilent" të partisë, me vendim të Këshillit të Ministrave datë 21 gusht 1950, në qytetet kryesore të Shqipërisë u hapën disa dyqane speciale të njohura si dyqane valute. Në këto dyqane lejohej që të bliheshin disa mallra që nuk gjendeshin në dyqanet e zakonshme, kundrejt arit, stolive të çmuara apo vlerave valutore, të cilat konvertoheshin me një kurs qesharak.

Grabitja mori dimensione aq marramëndëse sa që në vitin 1954 u shtetëzuan edhe sendet me vlerë, unazat, orët e lara me ar dhe kutitë e argjendit të të sëmurëve të spitalit neuropsikatrik të Vlorës.

Në proceset e kundërshtarëve politik të Enver Hoxhës të njohur si tarafi i Koçi Xoxes dhe projugosllavë, u zbulua se në kasafortat e tyre në momentin e arrestimit përveç bizhuterive, sendeve me vlerë dhe monedhave, kishte edhe dhëmbë floriri që u ishin shkulur tregtarëve të ndryshëm para dhe pas pushkatimit.

Për të hetuar këtë grabitje monstruoze nga regjimi komunist, më 22 janar 1992 u ngrit një komision parlamentar. Nga hetimet e bëra rezultoi se nga burime të ndryshme dilnin shifra kontradiktore. Kështu duke u mbështetur në dokumentacionin e Arkivit Qendror të Shtetit nga viti 1947-1980 dilte se ishin konfiskuar 2 017 kg ar, Thesari i Shtetit konstatonte sasinë 3029 kg, ndërsa nga Arkivi i Ministrisë së Brendshme dokumentohej 2 509 ar i konfiskuar. Atëherë u pa e nevojshme që t`u bëhej thirrje tregtarëve që ishin ende gjallë të sillnin dëshmitë e tyre lidhur me këtë çështje. Nga kjo rezultoi se u paraqitën rreth 90 deklarata dhe rezultoi se vetëm atyre u ishin konfiskuar 3.584 kg ar. Kjo tregon se shifra e vërtetë e konfiskuar nga organet e sigurimit të shtetit ka qenë shumë herë më e madhe se sa është deklaruar zyrtarisht.

Nga Ejup Lila

Kalimi i shpejtësisë së dritës... Të udhëtosh në fantazi

A do e kalojë ndonjëherë shpejtësinë e dritës?

A do të kalohet ndonjëherë shpejtësia e dritës? Kjo është pyetja që po i bëjnë vetës prej disa vitesh radhazi shkenctarët e CERN. Një pyetja sa interesante po aq edhe provokative.

Fillimisht duhet të rikujtojmë lajmin që bëri bujë. Fizikantët e CERN deklaruan se pjesëzat e atomit, neutronet kaluan kufirin e shpejtësisë së dritës. Ky eksperiment gjeneroi mjaft kënaqësi dhe u mirëprit, edhe pse neutronet në fjalë udhëtonin nanosekonda më shpejtë se drita. Eksperimenti kështu hedh poshtë shpejtësinë kozmike të përcaktuar nga Ajnshtajni në vitin 1905. Shumë shkencëtarë dolën kundra kësaj deklarate dhe e mohuan atë. Koha tregoi se ky mohim ishte i drejtë. Gjatë llogaritjes së të dhënave ishin bërë gabime. Shpejtësia e dritës nuk ishte kaluar.

Shpejtësia e dritës është gur themeli në teorinë e relativitetit të Ajnshtajnit, e cila na jep konceptin e shkakësisë: shkaqet paraprijnë efektet, kudo që të jemi. Por, shkencëtarët mendojnë se jo çdo gjë që ka thënë Ajnshtajni do të jetë e vërtetë deri në përjetësi. Kjo është arsyeja që i shtyn ata të eksperimentojnë.

"Besim i brishtë"- kjo është fraza që mund të përdoret në këtë rast. Ashtu si çdo objekt me masë që përshpejton, ashtu dhe protonet fitojnë energji. Por, problem është se masa nuk është konstante. Me rritjen e masës duhet edhe të rrisim energjinë. Gjithmonë ka nevojë për energji që të përshpejtojë udhëtimin. Sa më shumë energji t'i japim protonit, aq më afër shpejtësisë së dritës arrin ai, por, kurrë nuk e kalon. Për një masë infinit duhet një energji infinite. Për të kaluar shpejtësinë e dritës kemi nevojë për energji infinit, një energji të cilën ne nuk e prodhojmë dot.

Ekuacionet nuk kanë tendencë të gënjejnë. Shumë ekuacione janë testur dhe ritestuar nëpër eksperimente për më shumë se një shekull. Por të gjitha të dhënat eksperimentale tregojnë se shpejtësia e dritës është një prag i pakapërcyeshëm.

Të mendosh se do të kalohet shpejtësia e dritës është sikur të mohosh ligjet themelore të fizikës. Problemi është se ne nuk mund të themi: "Çfarë do të ndodhë në qoftë se udhëtojmë me shpejtësinë e dritës?" Sepse kjo është krejtësisht e pamundur fizikisht. Fizika është një paketë e plotë ligjesh: Një herë që ju mohoni një ligj fizike, njëkohësisht keni mohuar të gjithë ligjet e fizikës.

Të bësh një pyetje të tillë është sikur të pyesësh se çfarë ndodh me një numër, po të pjesëtohet me zero?



Apo çfarë ndodh nëse unë kthehem në kohë dhe vras gjyshin tim, para se unë të lindja?

Të tilla mendime i gjejmë vetëm nëpër librat fantastiko-shkencorë dhe në filma të ndryshëm. Imagjinoni sikur ju ka ftuar një shoku juaj për darkë dhe ju nuk keni arritur të shkoni dot. Duke kaluar shpejtësinë e dritës ju arrini të udhëtoheni në kohë dhe të ktheheni për të ngrënë darkën e shokut tuaj.

Të gjitha këto janë fantazira dhe njeriut kënaqet kur i mendon këto. Po japim një tjetër shembull. Në qoftë se ne gjuajmë një gurë me shpejtësinë e dritës drejt një xhami, ai e kalon xhamin, por xhami nuk thyhet. Xhami nuk thyhet, sepse nuk ka kohë të thyhet, për arsye se guri udhëton në kohë.

Lidhja me shpejtësinë e dritës dhe kohën është shumë e ngushtë. Imagjinoni sikur të gjithë të udhëtonin në kohë. Ne do të arrinim të jetonim shumë gjatë, sepse nuk do plakeshim . Arsyeja e plakjes është koha. Shkencëtarët e shohin kohën si dimension të katërt dhe është ajo shkaktare e plakjes sonë dhe e vdekjes. Por, duke udhëtuar me shpejtësinë e dritës ne udhëtojmë në kohë dhe unë do të kisha mundësinë të shikoja edhe stërnipërit e mi.

Po të mendojmë mirë, njeriu zotëron aftësi që e kalojnë shpejtësinë e dritës. Sapo e thamë "po të mendojmë", pra është shpejtësia e mendimit. Dritës i duhen 8 minuta për të ardhur nga dielli në tokë, por ne na nevojitet më pak se 1 sekondë që të mendojmë diellin. Njeriu arrin ta kalojë shpejtësinë e dritës edhe nëpërmjet ëndrrës. Çdokujt mund t'i ketë ndodhur që në ëndërr të shikojë diçka që do të ndodhë në të ardhmen. Shkencëtarët mendojnë se ky është një udhëtim i shpirtit shumë më shpejtë se drita në të ardhmen. Fantazirat nuk kanë të mbaruar. Megjithatë, fizika thotë se kalimi i shpejtësisë së dritës është e pamundur.

Nga Marenglen Kume

Viti i "inteligjentëve"

Viti 2013 që sapo lamë mund të quhet viti i gjeneratës së smartfonëve. Pavarësisht krizave që kërcënojnë ekonomitë e shumë vendeve, kompanitë e telefonave celulare nuk reshtën së sjelluri risi për konsumatorët e tyre. "Gjigantët" e tregjeve celulare (si Samsung, Apple, HTC, etj.) arritën të prodhonin disa nga smarfonet më të zhvilluar dhe funksional për përdoruesit e tyre.

Secila në konkurrencë të hapur me njëra-tjetrën me target të vetëm: shitjen e produktit të tyre në të 4 cepat e botës. Ata sollën inovacione dhe risi të reja në këtë fushë. Samsung-u vazhdoi me serinë e tij të tipeve "Samsung galaxy" duke prodhuar versionin e 4 të tij "Samsung galaxy S4". Ai doli më një ekran më të madh: 5 inç me rezolucion 1080 x 1920 piksel. S4-a është më përmasa 139.7 x 71.3 x 9.1 mm dhe peshon vetëm 153 gram.

Apple si një nga iniciatorët e kësaj fryme teknologjike prodhoi "Iphone 5, 5c, 5s", një seri telefonash celularë rrënjësisht të ndryshëm nga të tjerët. "HTC", "BlackBarry", "LG" etj. nuk mund të rrinin pas në këtë "luftë" të hapur për të pushtuar tregun botëror të smartfonëve. Risia e kompanisë "Blackberry" ishte smartfoni "Blackberry z30", i cili doli në treg në shtator të 2013. "Z30" erdhi në versionin smartfon me një ekran 5.00 inch 720x1280.

Mikrosoft ndërkohë zgjodhi kompaninë "HTC" për të pasur ekskluzivitetin e prodhimit të smartfonit me program Ëindoës. Smartfoni i quajtur " HTC Ëindoës Phone 8X" operon me programin Ëindoës 8 me shpejtësi 1.5 GHz me memorje të përgjithshme 16 giga dhe 1 giga RAM.

Pavarsisht kostos, të apasionuarit pas teknologjisë që s'mund të bëjnë dot pa aparate të tilla në jetën e tyre që t'i zgjidhin disa nga problemet edhe me rutinë, bëjnë çmos për t'i siguruar këto celularë pa dalë mirë në treg. Pjesa tjerër duhet të sakrifikojë diçka më shumë për të pasur këtë trend të kohës.

Nëse përdor një celular "inteligjent" mund të kryesh shumë punë njëkohësisht. 2014 pritet që të jetë shumë e suksesshme në fushën e teknologjisë. Inxhinierët e kompanive celulare janë duke punuar për produktet e reja të tyre, që me shumë gjasa do na çudisin duke na i mundësuar të gjitha paisjet (kompjuter, televizor, radio etj.) në një paisje të vetme: celulari.

Nga Jonida Halili

Unë mund të luaj futboll. Po ti?

Sot në Shqipëri, në një fushë futbolli nuk shohim më vetëm meshkuj. Stadiumet shqiptare dhe komplekset sportive kanë marrë një pamje tjetër. Në lojë kanë hyrë edhe femrat. Ato kanë hedhur pas krahëve tabunë se femrat nuk dinë dhe nuk mund të luajnë futboll. Pak vite më parë çuditeshe të shihje femra në fushë, më ato veshjet e gjera, takat "e meshkujve" dhe mbrojtëset e gjunjëve poshtë çorapeve. Tani jo më! A janë vërtetë të afta dhe deri ku arrin pasioni i femrave për futbollin? Nëse dinë të luajnë, a mundet vallë të përfaqësojnë Shqipërinë më mirë se sa meshkujt?

Historia e futbollit të femrave në Shqipëri nisi në vitin 2008 me idenë dhe mbikëqyrjen e ish-futbollistit dhe trajnerit aktual të kombëtares së femrave, Altin Rakli. Skuadra e parë shqiptare ishte "Tirana AS", e cila vijoi me një sukses të madh. Në vitin 2009, ajo fitoi kampionatin e parë në Shqipëri. Më vonë u krijuan dhe skuadra të tjera, si: "KF Tirana", "Ada e Velipojës", "Juban Danja", "Dardania", "Kinostudio", "Shkëndija e Durrësit", "The Door", "FC Kamza" etj. Këto skuadra kanë pasur aktivitete të shumta dhe rezultate të kënaqshme. Futbolli i femrave, ashtu si i meshkujve, është nën administrimin e Federatës Shqiptare të Futbollit.

Përfaqësuesja jonë e femrave aktualisht është në grupin e pestë të kualifikuesve të Kampionatit Botëror "Kanada 2015", së bashku me Norvegjinë, Belgjikën, Holandën, Portugalinë dhe Greqinë. Për të dhënë një ide më të qartë, ne kemi realizuar intervistë me një nga futbollistet më të spikatura të kombëtares sonë të futbollit, Ellvana Curon.

Ellvana u lind më 22 janar 1992 në Australi. Babai i saj është ulqinak dhe nënë shkodrane (çfarë rëndësie ka kjo e dhënë?). Aktualisht Ellvana Curo aktivizohet në repartin sulmues me skuadrën e Melburnit në kampionatin australian. Për revistën "Objektiv" ajo zbulon detaje interesante nga jeta e saj, si edhe nga futbolli.

Ellvana, ju konsideroheni si një nga futbollistet më të mira të kombëtares shqiptare të femrave. Si ka filluar e gjithë kjo, cila ka qenë shtysa?

Është emocionuese të kenë të tjerët një konsideratë të tillë. Unë mendoj se kjo arrihet me punë dhe me vullnet. Shtysa ime më e madhe ka qenë dhe vazhdon të jetë babai im. Ai gjithnjë më ka motivuar dhe më ka përkrahur për çdo hap që unë kam hedhur në fushën e futbollit, por sigurisht edhe familjarët e tjerë. Fatmirësisht, unë jam rritur në një ambient, në të cilën e nuhasje sportin në çdo vend. Një pjesë e mirë e familjes janë marrë me aktivitete të ndryshme sportive, si futboll, volejboll etj.

Mbani mend ndonjë detaj nga hera e parë kur keni luajtur futboll?

E mbaj mend shumë mirë. Hera e parë që unë kam luajtur futboll ka qenë me një klub vajzash afër shtëpisë time kur unë isha vetëm 12 vjeçe. Më pas më erdhi një ofertë nga një trajner i atij klubi dhe unë me dëshirën e madhe pranova pa insistim. Këtu filloi gjithçka.

Po më pas si vazhdoi rrugëtimi juaj?

Në moshën 18-vjeçare kam filluar aktivitete të rëndësishme duke qenë pjesë e klubeve në Melburn. Kam marrë pjesë në Ligën e Parë të femrave. Mbaj mend një vit më pas, në 2011, trajneri Julian Zeri më pa duke luajtur në Ligën e Melburnit me një skuadër. Pasi mbaroi ndeshja, ai m'u afrua dhe më pyeti për vendlindjen time, pasi nga emri dalloi që unë isha me origjinë shqiptare. Më sugjeroi të bëja një provim me kombëtaren e femrave në Shqipëri. U ndjeva shumë e lumtur që ma dha këtë mundësi dhe kam pranuar menjëherë, e lumtur dhe shumë krenare.

Sa e vështirë është për një femër të luajë futboll?

Kjo është relative. Varet nga mundësitë dhe dëshira. Unë personalisht nuk e konsideroj aspak të vështirë, përkundrazi dashuria ndaj futbollit ma bënë shumë më të lehtë. Pa dyshim që ka peripecitë e veta si në çdo vend, por jo e mundimshme.

Angazhimet e futbollit a janë pengesë për jetën tuaj personale? Çfarë angazhimesh të tjera keni jashtë futbollit?

Pengesë nuk mund të them, por sigurisht që merr një pjesë të konsiderueshme të kohës. Aktualisht po luaj më skuadrën e Box Hill në Melburn dhe stërvitem 4 ditë në javë, gjithashtu kam çdo javë një ndeshje, domethënë 5 ditë në javë is (?) ndaj futbollit. Gjithashtu, jam në vit të fundit në universitet dhe studioj për zhvillim të pronës komerciale.

Cilën konsideroni si skuadrën model të meshkujve në botë?

Më pëlqen dhe e ndjek vazhdimisht skuadrën e Barcelonës. Një skuadër me futbollistë shumë të talentuar dhe të koordinuar. Mbase duhet të shërbejë edhe si model për kombëtaren e meshkujve në Shqipëri.

Ç'mendim keni për futbollin shqiptar në përgjithësi?

Jam optimiste për ecurinë që ka pasur Shqipëria gjatë këtyre viteve të fundit. Duhet pranuar fakti se në Shqipëri ka jashtëzakonisht shumë tifozë në botë. Në ndeshjet që merr pjesë në vende të ndryshme, unë vë re një mbështetje të madhe nga tifozët. Kjo është tepër emocionuese. Mendoj se çdo vit skuadra ka pasur progres, sidomos kombëtarja e meshkujve që ka qenë vjet shumë afër botërorit. Gjithashtu, skuadra e femrave ka kaluar fazën preliminatore, që do të thotë kualifikim në botëror për herë të parë. Unë besoj se shumë shpejt kombëtarja e femrave dhe meshkujve do të ketë një renditje të mirë në botë.

Ju keni mundësi të luani në dy shtete, a e konsideroni veten me fat për këtë mundësi?

Unë them se po. Kam përfaqësuar atdheun tim. Gjithashtu kam luajtur edhe për (e kam shtuar unë) vendin ku kam lindur dhe jam rritur. Kjo është diçka e pamundur, tepër e rrallë. Kam pasur shumë fat që kam arritur të luaj me Shqipërinë, pasi jetoj në një vend të largët, siç është Australia. Ndihem shumë krenare që kam veshur fanellën kuqezi dhe shpresoj se çdo vit do të ecim përpara. Nuk mund të bëhesh kampione pa punuar fort, pa sakrifikuar dhe prandaj duhen pritur disa vite që gjërat të ndryshojnë.

Cila ju fal më shumë emocione, Australia apo Shqipëria?

(qesh)... Unë nuk mund t'i ndaj, është e vështirë. Në Melburne kam lindur. Ndërsa Shkodra është vendlindja e gjyshërve të mi. Të dyja kanë të veçantat e tyre. Ndihem mirë te të dyja.

Një mesazh për të gjitha femrat shqiptare që aspirojnë futbollin?

Nëse keni një pasion, një dëshirë, luftoni qoftë edhe për ta provuar. Me punë dhe vullnet arrihet gjithçka. Falënderoj shumë familjen time për të gjithë kontributin dhe të gjithë atyre që besuan tek unë dhe te talenti im.

UNE LUAJ FUTBOLL, PO TI?

Skuadrat me të cilat është aktivizuar Ellvana Curo:

- 2007-2009: Preston Lions / 26 ndeshje / 11 gola.
- 2009-2010: Heidelberg United ËFC / 5 ndeshje / 2 gola.
- 2010: Ashburton ËSC / 15 ndeshje / 8 gola.
- 2011: Alton City ËSC / 6 ndeshje / 11 gola.
- 2012: South Melbourn / 7 ndeshje / 8 gola.

KLINIKA DENTARE "VRIONI"

Cilësia, pasioni ynë.

IMPLANTOLOGJI IMEDIATE
Të gjithë ju që keni mungesë të një-disa ose të gjithë dhëmbëve dhe nuk dëshironi të qëndroni pa dhëmbë apo të mbani proteza të lëvizshme, mjafton një vizitë tek ne dhe brenda 24 orëve ju do të keni dhëmbë fiks (të pa lëvizshëm) mbi implante.

ORTODONCI
(Drejtimi i dhëmbëve)
Trajtim me aparate të lëvizshëm dhe fikse metalike, fikse qeramike (estetike të padukshme), Invisalign, për drejtimin e dhëmbëve dhe korrigjimin e problemeve të kafshimit. Konsulta dhe studimi i rastit falas.

PËR FËMIJËT
Shërbim i specializuar në një ambient të dizenjuar enkas për fëmijët ku ata mjekohen, duke u relaksuar e argëtuar

SEDACIONI
Mjekimi nën efektin e Gazit Gazmor. Në rastet e frikës nga punimet dentare tek të rriturit apo fëmijët, kryhen punimet nën efektin qetësues të protoksidit të azotit.

STOMATOLOGJI ESTETIKE
Ndërthurje e materialeve të gjeneratës së fundit (IPS Empress,IPS E Max) me ndërhyrjet kirurgjikale për gingivat.

KIRURGJI ORALE
Ura Porcelani metal-porcelan, zirkonium, Alumina (ura krejt qeramike, pa metal)

SHËRBIM KOMPLEKS
Staf mjekësh profesionist, të diplomuar e specializuar në Turqi & Itali



Adresa:
Tek 21 Dhjetori, Rr. Frosina Plaku, ndërmjet hotel "Mondial" dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, 50 m. nga "Unaza". Tel: 04222 1637 Cel: 0672005000, 0684079989, 0692306899
www.vrionidental.com